ISSN: 2078-7111

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË

BULETINI SHKENCOR
SCIENCE BULLETIN

Viti XXIX i botimit, nr. 36, 2024

(Seria e shkencave shoqërore)

BULETINI SHKENCOR
I UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”
(Seria e Shkencave Shoqërore)
Viti XXIX i botimit,
Nr. 36, 2024
(Botim kushtuar figurës së filantropit
Thoma Turtulli)

SCIENTIFIC BULLETIN
(Series in Social Sciences)
Publication Year XXIX,
Nr. 36, 2024
(Dedicated to the figure of the philanthropist
Thoma Turtulli)

Korrik, 2024

BORDI SHKENCOR
Kryetar: Prof. dr. Dhimitri Bello

Anëtarë: Prof. dr. Gjergji Pendavinji
Prof. dr. Ali Jashari
Prof. dr. Robert Damo
Prof. dr. Irena Nikaj
Prof. dr. Lorenc Ekonomi
Prof. as. dr. Ledina Alolli
Prof. as. dr. Sonela Stillo
Prof. as. dr. Jonela Spaho
Prof. as. dr. Gjergji Mero
Prof. Ionel Roventa*, Universiteti i Craiovës, Rumani*
Assoc. Prof. Mihaela Alexandrina Popescu*, Universiteti i Craiovës, Rumani*
Prof. Elena Griva*, University of Western Macedonia*
Ass. Prof. Anastasia Yannakopoulou*, University of Western Macedonia*
Assoc. Prof. Gergana Padareva *– Faculty of philology, "Neofit Rilski", Blagoevgrad*
Assoc. Prof. Bilyana Todorova *– Faculty of philology, "Neofit Rilski", Blagoevgrad*
Assoc. Prof. Nikolay Atanasov*– Technical faculty, "Neofit Rilski", Blagoevgrad* ***Assoc. Prof. Daniela Tomova*** *– Faculty of pedagogy, "Neofit Rilski", Blagoevgrad*
Assoc. Prof. Bilyana Yordanova *– Faculty of philosophy, "Neofit Rilski", Blagoevgrad*
Assoc. Prof. Emil Gachev *- Faculty of Mathematics and Natural Sciences, "Neofit Rilski", Blagoevgrad*
Prof. dr. Vaska Stancheva-Popkostadinova *- Faculty of Public health, health care and sport, "Neofit Rilski", Blagoevgrad*
Assoc. prof. Miglena Simonska-Tsatsova *- Faculty of Public health, health care and sport, "Neofit Rilski", Blagoevgrad*
Prof. Georgios Floudas*, Dean of the Sciences School, University of Ioannina*
Prof. Evangelia Karagianni-Karagiannopoulou, *Dean of Social Sciences School, University of Ioannina*
Prof. Katerina Plakitsi*, Head of the Department of Early Childhood Education of the University of Ioannina.*
Akis Tsonos, PhD *of the University of Ioannina, Archaeologist, Secretary of the I.T.C.C. and Associate Lecturer at the Demokritus University of Thrace, Komotini, Greece.*
Aris Papayiannis, Ma *of the University of Crete, Treasurer of the I.T.C.C. and Archaeologist of the Ephorate of Antiquities of Magnesia (Thessaly).*
Maja Gori, PhD*, Researcher at Istituto di Scienze del Patrimonio Culturale del Consiglio Nazionale delle Ricerche (ISPC – CNR), Italy, and Associate Lecturer at the Institute of Prehistoric Archaeology of the Freie Universität, Berlin, Germany.*
Stavros Oikonomidis, PhD *Adjunct Professor of Greek Archaeology Arcadia University, Glenside, USA The Greek – Albanian Archaeological Expedition at the Tri – National zone of the Prespes*

Silvia Kirova, Assoc. Professor, PhD *Deputy Head, International Economic Relations and Business Department University of National and World Economy, International Economic Relations and Business Dept. Sofia*
Elisabeth Yoneva, Associate Professor*, Vice-Dean in Scientific and Research Activity – Faculty of International Economics and Politics, Department of International Relations, University of National and World Economy, Sofia.*
Prof. dr. Gentian Kostandini*, University of Georgia, USA*
Prof. dr. Elton Mykerezi*, University of Minnesota, USA*
PhD. Roy Alden Adwood, Honorary President & Member of the President's Advisory Board, Evangelia University, Anaheim, CA, USA

KOMISIONI I BOTIMEVE
Kryeredaktor*: Prof. as. dr. Benita Stavre*

Redaktorë*: Phd. Jordan Jorgji*
Prof. as. dr. Rafail Prodani
Dr. Ermiona Braholli
Dr. Eneida Çifligu
Dr. Klaudeta Merollari
Dr. Zhinzela Qyli

Redaktor gjuhësor:
Msc. Eftiona Bylykbashi

PUBLIKUAR NGA
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË
SHËTITORJA
"RILINDASIT" KORÇË,
SHQIPËRI

PUBLISHED BY
UNIVERSITY "FAN S.
NOLI" KORCE
SHETITORJA
"RILINDASIT"
KORCA, ALBANIA

Website: www.unkorce.edu.al

ISSN: 2078-7111

TABELA E PËRMBAJTJES

Ese filozofike "Shpirtdhuruesi" **(**kushtuar figurës së filantropit Thoma Turtulli)……**8**

I- BUJQËSI

Kultivimi dhe efektiviteti ekonomik i Aronia Melanocarpa (Aronia e Zezë) në kushtet klimatiko-tokësore të rajonit të Korçës
Avni SPAHOLLI
Ilir NIÇKO
Eneida ÇIFLIGU
Miron MERSINLLARI. 11

Prodhimi biologjik i bimëve mjekësore-aromatike dhe qëndrueshmëria e fermave bujqësore
Adrian MAHO
Gjergji MERO
Besnik SKËNDERASI
Sulltane AJÇE 23

II- SHKENCA EDUKIMI

Embracing AI in Foreign Language Learning: The University Students' Perspective
Lela IVANOVSKA
Silvana NESHKOVSKA
Milena KASAPOSKA-CHADLOVSKA
Vesna
TRAJKOVSKA.....35

True or False? University Student's Views on 'Fake News' in Primary Education
Menelaos TZIFOPOULOS..... 62

III- SHKENCA GJUHËSORE/ GJUHË E HUAJ

Vështrim historik mbi fjalëzën 'Një' në gramatologjinë shqipe
Hysnie HAXHILLARI (HYSKA)..... 75

Një qasje diakronike rreth togjeve të qëndrueshme në gjuhën angleze
Suela KOÇA 91

IV- HISTORI/ TRASHËGIMI KULTURORE
World Heritage Site of Butrint, Albania: Tourists' Perceptions and Management
Edlira MENKSHI
Ermira JASHIKU 108

Valorising Historical Archives for the Tourist Promotion of a Territory. A Field Research Between Albania and Italy
Idamaria FUSCO
Olga LO PRESTI
Geltrude MACRÌ
Metin VENXHA 122

Ballkani nga Lufta e Parë Ballkanike në fund të luftës greko-turke (1912-1922)
Orjon AGO
Metin VENXHA 138

SHPIRTDHURUESI

Ardian MATKA
Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
Universiteti "Fan S. Noli"

Dedikuar figurës së filantropit korçar Thoma Turtulli!
"Shpirtdhuruesi"

Zigmunt Bauman, në veprën e tij ***"Moderniteti i lëngët"***, në problematikat që trajton, midis të tjerave kur flet për qytetin, i referohet ***George Hazeldon***, një arkitekt britanik, i cili jeton në Afrikën e Jugut. Si profesionist që është, ai ka një ëndërr, të ndërtojë një qytet që nuk ngjason me qytetet e zakonshme, një qytet sipas përmasës së individëve, të cilët dëshirojnë të menaxhojnë dhe monitorojnë bashkësinë në të cilën jetojnë.

Edhe qyteti ynë, Korça, me të cilin krenohet padyshim çdo shqiptar, brenda dhe jashtë vendit, ka historinë dhe evolucionin e saj të zhvillimit ndër shekuj.

Në këtë linjë ndryshimi dhe zhvillimi të pandërprerë, në përputhje me qëllimin dhe organizimin e aktivitetit të sotëm, do të përpiqem të shkëput, sjell para jush dhe trajtoj një moment shumë të rëndësishëm, por të lënë në harresë, me qëllim ose jo (këtë nuk di ta them, por e konstatoj), veprimtarinë e një njeriu me ***"zemër të madhe"***, siç shpreheshin bashkëqytetarët e tij: ***"Sa Korça"***, ***Z. Thoma Turtulli***.

Qyteti është një bashkësi njerëzish, të cilët karakterizohen nga marrëdhënie të ngushta, të ndërsjellta midis tyre, por edhe që bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në dy lloj ***hapësirash urbane: hapësira publike dhe hapësira qytetare***, kjo sipas studiuesit ***Klod Levi Stross***.

Nga ana tjetër, jeta urbane sipas ***Richard Sennet***, kërkon një lloj tharmi të veçantë, një tërësi aftësish dhe vlerash, të cilat mbrojnë njerëzit nga njëri-tjetri dhe lejojnë t'i gëzohen pranisë së njëri-tjetrit pa i bezdisur.

Nga sa mësojmë kur lexojmë jetën e ***Z. Thoma Turtulli***, ai që në moshë të vogël i njohu të dyja këto hapësira të qytetit, atë publike, ***Tregun***, ku punonte si ndihmës i të atit dhe atë qytetare si banor i Korçës ku jetoi dhe kontribuoi. Qytetaria, ashtu gjuha nuk mund të jetë private, përpara se të bëhet art, ajo është tipar i mjedisit shoqëror.

Thomai 12-vjeçar ra në sy të të atit në shitjen e mallrave ushqimore dhe sendeve të tjera. ***"Ishte kaq i shpejtë sa nuk i dukeshin***

duart, kishte një buzëqeshje të çiltër dhe çuditërisht shumë i dashur. Gati pa shënuar asgjë me laps, ishte i gatshëm të thoshte në çast sesa kushtonin mallrat e blerë. Nëse llogarinë e kishte bërë gabim dhe blerësit i kishte mbajtur qoftë edhe një qindarkë më shumë, ai trishtohej i gjithi, sepse porosia e babait të tij kishte qënë*: *"Me njerëzit duhet të jesh i drejtë biri im"".

Rusoi, ky filozof i madh francez, në lidhje me marrëdhëniet midis njerëzve pyeste: Ç'mund t'i karakterizojë marrëdhëniet ndërnjerëzore? – ***Mëshira***, ajo më shtyn spontanisht drejt tjetrit, që të bëhem fli për të mirën e tij. Ndërkohë ***autorë të tjerë*** e shohin këtë zgjidhje të Rusoit si një ***llogari hipokrite***, sepse mëshira është shpesh një ndjenjë për të këqijat tona tek të këqijat e të tjerëve, një parashikim i shkathët i fatkeqësisë ku ne mund të biem.

Falë kësaj ndershmërie që i karakterizonte si familje dhe fis, tregëtia u zgjerua përtej kufijve të Korçës dhe Shqipërisë. ***"Të bësh tregëti me Thomain është mbarësi"*** – shpreheshin tregëtarët e asaj kohe.

Por Ai ishte edhe banor i Korçës, edhe individ i hapësirës së dytë, asaj qytetare, edhe qytetar i imazhit të qytetit sipas përmasës së individëve që dëshirojnë të menaxhojnë bashkësinë dhe qytetin ku jetojnë dhe si i tillë filloi ta shqetësojë një problematikë e tillë:

A mundemi ne ta bëjmë Korçën vetë?

A duhet të jemi të gjithë bashkë dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin?

Sartri, gjatë refleksioneve të veta filozofike mbi "***Tjetrin***", kishte theksuar rëndësinë e ***Tjetrit*** si një ndërmjetës i domosdoshëm midis ***Unit*** dhe ***Vetvetes***. Portat e shpirtmadhësisë së Tij tashmë ishin hapur. Dhe Atë drejt tjetrit nuk e shtyu mëshira e Rusoit, por parimi i dhurimit, parimi për të dhuruar. Nëse i jep lëmoshë një lypësi, këtë e bën për parim, apo për faktin që nesër kur të jesh në pozitat e tij, të ta kthejnë?

Shumë shpejt së bashku me të shoqen ***Athinanë***, u kujdesën për ***Jetimoren*** e mbetur pa drejtues, vendosën të ngrejnë një Jetimore të re. ***"Paraja nuk të bën të lumtur, i lumtur mund të jesh vetëm për aq kohë sa përpiqesh t'i bësh të tjerët të lumtur"***.

Tashmë fillon ta shohë Korçën me sy tjetër. Njerëzitveçanarisht të rinjtë duhet të ndryshonin veprimtaritë e tyre të jetesës. I lindi ideja e Kinemasë, ku të rinjtë të kishin ç'të mësonin prej filmave.

Nga ana tjetër, këshillat e tij për brezin e ri ishin kuptimplotë: ***"Përse e vrisni kohën kot more djem dhe nuk merreni me libra? Do t'u ngre një Bibliotekë të bukur ku të gjithë të shkojnë të lexojnë"***.

Ndonëse vetë nuk e pati luksin e studimeve, e kishte kuptuar qartë tezën sokratike: ***"Të gjitha të këqijat na vijnë nga padituria"*** dhe atë karteziane: ***"Dija është forcë"***. Në këtë aspekt shërbeu ndërtimi i ***Liceut***.

Parimi për të dhuruar dhe jo mëshira e dhurimit, kjo moto e bashkëshortëve Turtulli duket qartë edhe tek ideja tjetër gjeniale e ndërtimit të një ***Spitali*** me 3 kate të pajisur edhe me ngrohje me pajisje nga më modernet e kohës. Të gjthë të sëmurët u lutën në Kishën e Shën Marisë për shëndetin e Tij, Bashkia nxitoi të garantojë truallin, Parlamenti i asaj kohe mbajti fjalime për të, kurse të gjithë njerëzit e qytetit shpreheshin: ***"Bashkëshortët Turtulli kanë një zemër të madhe sa vetë Korça"***.

Në përfundim: Ai dhuroi shpirtin e pavdekshëm dhe jo materien që transformohet pandërprerë. Shpirti ngelet!

A nuk është shpirti i tij në secilën prej materieve të dhuruara?

A nuk ndodhet ai në secilin prej nesh që edukohet, studion dhe punon në këtë godinë?

A nuk ndodhet ai në çdo raft e libër, siç thotë i madhi Dritëro, të Bibliotekës? Për ta mbyllur, po sjell para JUSH tri thënie të filozofit antik kinez **Lao Tzu:**

Mirësia te fjalët sjell besim!

Mirësia te mendimet sjell thellësi!

Mirësia duke dhënë krijon dashuri!

I- BUJQËSI

KULTIVIMI DHE EFEKTIVITETI EKONOMIK I ARONIA MELANOCARPA (ARONIA E ZEZË) NË KUSHTET KLIMATIKO - TOKËSORE TË RAJONIT TË KORÇËS

Avni SPAHOLLI
Ilir NIÇKO
Eneida ÇIFLIGU
Fakulteti i Bujqësisë
Universiteti "Fan S. Noli"

Miron MERSINLLARI
Fermer, Njësia Administrative Libonik, Fshati Libonik

Përmbledhje
Aronia është një nga superushqimet më të kërkuara në Evropë dhe në mbarë botën. Për shkak të kërkesës së konsumatorit për ushqime funksionale, kultivimi i aronias po rritet vazhdimisht. Vitet e fundit në vendin tonë është rritur interesi për aronian, arsyeja janë vetitë unike të frutave të saj, të cilat janë lëndë e parë e shkëlqyer për përpunim dhe klasifikohen si bimë mjekësore për përbërjen e tyre kimike. Në vendin tonë dhe në veçanti në Rajonin e Korçës aronia nuk njihet plotësisht dhe kultivohet në sipërfaqe shumë të kufizuar. Prova fushore u realizua në fushën e Maliqit me synim që të jepet një alternativë ndryshe dhe më efektive fermerëve të kësaj zone dhe më gjerë. Studimi kishte si qëllim të vlerësonte kultivimin e aronias së zezë në kushtet klimatiko tokësore të rajonit, të vlerësonte efektivitetin ekonomik të saj krahasuar me kulturat e tjera tradicionale që mbillen në këtë rajon, të rekomandojë zgjerimin e sipërfaqeve të mbjella me Aronia dhe modalitetet e tjera që lidhen me prodhimin dhe tregun e saj, bazuar në rezultatet e studimit. Në studimin fushor të aronias u përdorën fidanë 2 vjeçarë nga kultivari "Nero". Rezultatet e studimit treguan se kultura ka një përputhshmëri të plotë me kushteve klimatiko – tokësore të zonës ku u krye studimi dhe efektiviteti ekonomik ishte dukshëm më i lartë krahasuar me kultura te tjera.

Fjalë kyçe: *Studim, prodhim, superushqim, frutikulturë alternative, bujqësi, ushqime funksionale.*

CULTIVATION AND ECONOMIC EFFECTIVENESS OF ARONIA MELANOCARPA (BLACK CHOKEBERRY) IN THE CLIMATIC CONDITIONS OF THE KORÇË REGION

Abstract

Chokeberry is one of the most sought-after superfoods in Europe and around the world. Due to consumer demand for functional foods, chokeberry cultivation is constantly increasing. In recent years, the interest in chokeberry has increased in our country, the reason being the unique properties of its fruits, which are an excellent raw material for processing and are classified as medicinal plants for their chemical composition. Based on authentic data and literature sources, as well as the fact that in our country and in particular in the Korça region, chokeberry is not fully known and has not been cultivated, we carried out field experiments in the Maliqi field with the aim of giving to the farmers a different and better alternative, efficient to the farmers of this area and beyond. The aim of the study was to evaluate the cultivation of chokeberry in the climate and land conditions of the region, to evaluate its economic effectiveness compared to other traditional crops that are planted in this region, to recommend the expansion of the areas planted with chokeberry and other modalities related to its production and market, based on the results of the study. 2-year-old seedlings from the cultivar "Nero" were used in the field study of aronia. The results of the study showed that there is a complete compatibility with the climate-land conditions of the area where the study was conducted and the economic effectiveness was significantly higher compared to other cultures.

Keywords: *Study,, production, superfood, alternative fruticulture, agriculture, functional foods*.

1. HYRJE

Zbatimi i reformave në bujqësi dhe privatizimi i tokës me ligjin 7501 ishin të një rëndësie të veçantë për përballimin e situatës emergjente të ushqimit, në radhë të parë të popullsisë fshatare (Manoku Y. 2009). Fermerët, tashmë privatë dhe pa një alternativë tjetër për të jetuar, iu kthyen punëve në bujqësi. Aktualisht bujqësia shqiptare e reformuar përballet me sfida jo vetëm për shtimin e prodhimit në tërësi, por edhe në përballimin e presionit që rezulton nga integrimi dhe globalizmi i ekonomisë (Manoku Y., 2009). Për një kohë të gjatë fermerët kanë qenë të pa orientuar se çfarë do të kultivojnë në tokat e tyre. Në shumicën e rasteve ia kanë lënë rastësisë. Nevoja për një jetë më të mirë

i detyroi njerëzit që të emigronin jashtë vendit duke sjellë eksperienca të ndryshme në sektorin e bujqësisë. Gërshetimi i kapitalit me eksperiencën dhe dëshira për të ndërtuar jetën familjare në vendin e vet, bëri që shumë fermerë të guxojnë të investojnë në tokat e tyre. Studimi i paraqitur është një rast i tillë. Studimi paraqet kultivimin dhe efektivitetin ekonomik të aronias në kushtet klimatiko - tokësore të rajonit të Korçës, (rasti Fusha Maliq). Aronia e zezë (*Aronia melanocarpa* (Michx.) Ell.) është një shkurre gjetherënëse. Ajo kultivohet kryesisht në veri-lindje të Shteteve të Bashkuara dhe Kanada, por më shumë edhe në Rusi dhe Evropën Lindore (Gurčík Ľ, etj., 2023.). Aronia është një nga superushqimet më të kërkuara në Evropë dhe në mbarë botën. Fruti i Aronias është dëshmuar se është një nga antioksidantët më të fuqishëm të natyrës, i pasur me lëndë ushqyese dhe vitamina, duke ofruar përfitime të jashtëzakonshme për ata që duan të përmirësojnë shëndetin e tyre nëpërmjet zakoneve të ushqyerit të shëndetshëm. Aronia është bërë kohët e fundit një nga frutat më të njohura dhe të përdorura gjerësisht, dhe ka studime të shumta që merren me studimin e përbërjes së tyre kimike dhe aktiviteteve biologjike (Zdunic, G., etj., 2020). Nga analizimi i vlerave të frutit të aronias, janë përcaktuar; vlerat e pH-it, përmbajtja e glukozës, fruktozës, acidet organike, mineralet dhe vitaminat. Vlerat e pH-it luhaten nga 3.3–3.7; glukoza 41 g/l; fruktoz 40 g/l; acidi malik 13.1 g/kg; acidi citrik 2.1 g/kg; mineralet si kaliumi 2850 mg/l; kalciumi 322mg/l; magnezi 162 mg/l; hekuri 9.3 mg/l; zinku 1.47 mg/l. Vitamina $B_1$180 mg/kg, B_2 200 mg/kg, B_6 280 mg/kg, vitamina C 137 mg/kg, acidi pantotenik (B_5) 2790 mg/kg (Lupascu N., etj, 2016).

Për shkak të kërkesës së konsumatorit për ushqime funksionale, kultivimi i aronias po rritet vazhdimisht, për shembull, Polonia, e cila është prodhuesi më i madh në botë, rriti prodhimin e saj nga 38,000 në 58,000 tonë nga 2004 në 2013 (Platonova E. Y., etj., 2021). Pjesa më e madhe e prodhimit të aronias në botë është e bazuar në Poloni. Në vitin 2008 prodhimi polak ishte 35-40,000 tonë, ose 90% e prodhimit botëror. Nga kjo, 90% përdoret në formë lëngu për eksport në SHBA dhe vende të tjera. Vetë Polonia përdor 10% të frutave të mbetur (Makarenko V., 2008). Vitet e fundit është rritur interesi për aronian, arsyeja janë vetitë unike të frutave të saj, të cilat janë lëndë e parë e shkëlqyeshme për përpunim dhe klasifikohen si bimë mjekësore për përbërjen e tyre kimike (Q.T.T.B Vlorë, 2018). Në Kosovë aronia filloi

të kultivohet në vitin 2012 (Hoxha H., 2020), ndërsa në Shqipëri aronia ka filluar të kultivohet për herë të parë nga fermerët e Divjakës në vitin 2013. Aronia është pak e njohur dhe kultivohet nga fermerët në sipërfaqe të vogla për të rregulluar ekonominë familjare. Studimet shkencore rreth aronias kanë filluar nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Vlorë (Q.T.T.B Vlorë, 2018). Në rajonin e Korçës është studimi i parë i plotë dhe kishte si synim të vlerësonte kultivimin në kushtet klimatiko tokësore të Rajonit të aronias së zezë, të vlerësojë efektivitetin ekonomik të saj krahasuar me kulturat e tjera tradicionale që mbillen në këtë rajon, të shërbejë si një alternativë e re për fermerët për rritjen e sipërfaqeve të mbjella me aronia bazuar në rezultatet e studimit.

1.1. Karakteristikat botanike dhe rëndësia e kultivimit të aronias

Aronia e zezë (*Aronia melanocarpa* Michx. Ell.) është një kaçubë gjetherënëse me origjinë nga Amerika e Veriut, e klasifikuar botanikisht si pjesë e familjes Rosaceae. Bima e aronias rritet 1.2 deri në 2.4 m duke prodhuar lule të bukura të bardha dhe fruta me ngjyrë blu-blu me shije të athët dhe aromatike (Dragomir D., etj. 2022.). Për shkak të ngjyrës së bukur të gjetheve në vjeshtë dhe tufave të zeza të fryteve, bima është kultivuar për dekorim të kopshteve dhe parqeve. Përveç qëllimeve dekorative, ka edhe plantacione industriale të aronias, sepse frutat janë të ngrënshëm, dhe kanë përmbajtje të lartë të antioksidantëve rreth 15 herë më shumë se boronica (Lupascu N., etj. 2016.). Në fillim të shekullit XX, Ivan Michurin, botanisti i famshëm rus, vëmendjen e përqendroi te vlerat praktike të aronias. Ky ishte tentimi fillestar për përdorimin si fryt. Rritja e interesimit për kultivimin e aronias është për shkak të vetive të jashtëzakonshme të frytit (Hoxha H., 2020). Aronia është konsideruar si ‘superushqimi’ më i ri. Hulumtimet mjekësore kanë dokumentuar shumë përfitime shëndetësore të frutave të aronias. Shumica e efekteve të frutave të aronias janë për shkak të aktivitetit të tyre të lartë antioksidues. Frutat e aronias kryesojnë listën e më shumë se 100 ushqimeve që janë testuar shkencërisht për kapacitetin antioksidues (Zhang Y., etj. 2021). Antioksidantët reduktojnë dëmtimin oksidativ të qelizave njerëzore që mund të çojnë në kancer, sëmundje të zemrës, diabet, hipertension, hiperkolesterolemi. Aronia e zezë mund të përdoret në trajtimin dhe parandalimin e sëmundjeve të shumta (Zielińska M., etj. 2023). Aronia

është frut i ri ku përveç përdorimit në mjekësi (si ilaç), është bërë pjesë e ushqimit të shëndetshëm të kategorisë së parë në ditët e sotme (Hoxha H., 2020). Aktualisht fruti i aronias për shkak të fenoleve antioksidante, kërkohet në tregun botëror si një produkt dietik cilësor, i mirëpritur në ushqimin e përditshëm për forcimin e organizmit dhe promovimin e një stili jetese të shëndetshëm (Lupascu N., etj., 2016). Me rënien e mitit njerëzor mbi agrokiminë dhe përmirësimin sintetik të natyrës, bota po i kthehet ushqimit natyror dhe mjekësisë natyrore. Fruti i aronias (*Aronia melanocarpa* Michx. Ell.) duket se është një pikë referimi në këtë rrugë të kthimit për shkak të aftësisë së tyre unike për të kombinuar cilësitë e ushqimit të shëndetshëm dhe një agjenti terapeutik që mund të përshkruhet për shumë sëmundje të zakonshme të epokës sonë (Raţi I. V., etj., 2016). Për shkak të këtyre karakteristikave, aronia është bërë një specie shumë e kërkuar për kultivim në sistemin organik. Kërkesa për produktet organike po rriten dhe bujqësia organike shërben si burim të ardhurash për popullsinë në fshat (Dragomir D., 2022.). Studimet e fundit të realizuara sipas literaturës (Gurčík L., etj., 2023.) tregojnë se rritja e aronias së zezë është ekonomikisht më efikase në krahasim me kulturat konvencionale të kultivuara në një zonë prodhimi misri (gruri, misri dhe elbi) pavarësisht shpenzimeve të konsiderueshme për investime gjatë tre viteve të para të jetës së plantacionit. Zgjedhja më ekonomike për një subjekt biznesi është përpunimi i frutave të *Aronia melanocarpa* në formën e lëngjeve të frutave në krahasim me alternativën e shitjes së frutave të freskëta (Gurčík L., etj., 2023). Aronia futet në grupin e frutave alternativë të klasifikuar si "Frutikultura Alternative", krahas bimëve të tjera si boronica, mjedra etj. Si domosdoshmëri paraqitet sensibilizimi i popullatës shqiptare për vlerat ushqyese e mjekësore të përdorimit të frutave alternative, si dhe i fermerëve për kultivimin e tyre me përfitim jo vetëm nga përdorimi në tregun e brendshëm, por me përparësi në tregun evropian dhe global (Q.T.T.B –Vlorë, 2016.).

1.2. Kërkesat e aronias ndaj faktorëve ekologjike

Aronia përshtatet lehtësisht në kushte të ndryshme mjedisore dhe ka nevojë për ndriçim të mirë për të prodhuar rregullisht. Kërkesa vjetore për ujë për kultivimin e aronias janë 500-600 mm shi, por aronia është mjaft tolerante ndaj mungesës së lagështisë dhe lagështisë së tepruar. Për arsye të strukturës së rrënjëve të saj, aronia rritet mirë në toka me

ujëra nëntokësore të nivelit të ulët dhe të nivelit të lartë. Aronia jep prodhim të mirë në toka të pasura, argjilo-ranore, të ajrosura dhe me kapacitet të mjaftueshëm ujëmbajtës. Tokat gurishtore, me përmbajte të lartë zhavorri dhe tokat kënetore ose të kripura, janë pak të përdorshme. Aronia në përgjithësi, nuk rekomandohet të rritet së bashku me pemë apo shkurre të tjera frutore (Q.T.T.B Vlorë. 2018).

1.3. Kushtet klimatike të zonës së studimit

Klima është rezultantja e të gjitha situatave të motit dhe përbën gjendjen mesatare të atmosferës në një vend të caktuar. Klima e Shqipërisë, gjatë viteve të fundit, ka ndikime të klimës subtropikale, pra klimë më e ngrohtë. Dimrat janë më të ngrohtë dhe më të shkurtër, ndërsa stina e verës është më e gjatë dhe me temperatura më të larta. Temperatura mesatare vjetore në vitin e fundit ka shënuar rritje prej $+1.8^0$C. Sasia vjetore e reshjeve në formë dëbore dhe shiu, në dy dekadat e fundit, ka pësuar rënie prej rreth 20%. Ajo çfarë vihet re është se sasia e reshjeve që duhet të shpërndahej në harkun kohor të një muaji, tani na rezulton që bie në 4-5 ditë dhe ka intensitet të shtuar. Fusha ku u ngrit eksperimenti ndodhet në pjesën perëndimore të fushës së Maliqit dhe përfshihet në zonën e studimit të kushteve klimatike të stacionit Meterologjik Sheqeras. Rajoni i Korçës karakterizohet nga një klimë pjesërisht mesdhetare malore dhe pjesërisht kontinentale, me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare vjetore arrin deri në 10.6ºC. Muaji më i ftohtë është janari dhe muaji më i nxehtë është gushti. Muaji më i lagësht është nëntori me reshje shiu mesatarisht 104 mm ndërsa sasia mesatare vjetore e reshjeve arrin në 720 mm (IGJEO, 2021/2022). Zona e studimit karakterizohet kryesisht nga erëra lokale si Era Veriore (vjen nga gryka e Çërravës) dhe Era Cangonjare, (vjen nga gryka e Cangonjit), era jug-perëndimore etj. Ngricat dhe numri i ditëve me ngrica ishin të pakta dhe jo të ashpra kryesisht në zonën kodrinoro-malore. Kështu, ditët me ngrica (temperature më të ulta se 0^0C) në stacioni Sheqeras për muajin dhjetor 2022 ishin 8 ditë (IGJEO, 2021/2022). Rrezatimi diellor si burimi kryesor i energjisë dhe i nevojshëm për proceset fotosintetike paraqitet nëpërmjet vlerave të treguesit përkatës të orëve me diell. Në zonën e Korçës ka 2,309 orë me diell ndërsa në Sheqeras 2,390 orë. Në vitet e fundit në këtë hapësirë ky tregues rezulton të ketë pësuar një rritje me rreth +5%, që do të thotë se dhe vlerat e rrezatimit aktiv fotosintetik

(RAF) për proceset fotosintetike janë përmirësuar. Fusha e Korçës karakterizohet me një vlerë vjetore të rrezatimit diellor që arrin në vlerat 1600÷1700 W/m^2 /vit, ndërkohë që me ngritjen në lartësi shënohet një ulje deri në vlerat 1500÷1550 W/m^2 /vit. Rrezatimi aktiv fotosintetik (RAF) është një tregues i rëndësishëm në vlerësimin e agroklimës nga pikëpamja e potencialit që ajo ofron për proceset fotosintetike të bimëve në tërësi dhe po ashtu dhe për drufrutorët dhe vreshtarinë (Zorba P, etj 2021). Ngrohja globale ka dhënë efektet e saj edhe në këtë zonë. Kjo vihet re në tiparet e klimës kontinentale në dimër apo verë, të cilat sa vijnë dhe bëhen më dominuese. Dëbora shfaqet vetëm me stuhi 2-3 ditore duke shtruar por shumë shpesh kjo shtresë e bardhë zhduket pa ngrirë ende. Kjo vjen si pasojë e rritjes së menjëhershme të temperaturave të ajrit dhe njëkohësisht, e prezencës së reshjeve të shiut me intensitet të lartë.

2. MATERIALI DHE METODA

Prova eksperimentale fushore është mënyra e vetme që tregon nëse një bimë apo kultivar i saj mund apo jo të kultivohet në një zonë të caktuar dhe nëse është apo jo me efektivitet ekonomik. Për studimin në fjalë, prova fushore u ngrit në fshatin Libonik, njësia administrative Libonik, bashkia Maliq. Periudha e studimit ishte nga viti 2021-2023. Toka ku u ngrit eksperimenti ishte e tipit livadhore e kafenjtë (Luvisole), e kulluar mirë, me teksturë të mesme, mesatarisht e pasur me lëndë organike dhe fosfor, e pasur në potas dhe e mesme në azot dhe me pH 6.7. Parabima ishte patate dhe perime. Para mbjelljes tokës iu bë punimi i thellë dhe frezimi.

Figura nr 1: Fusha eksperimentale Libonik.
Experimental field in Libonik

Bimët u mbollën me largësi midis rreshtave prej 2.7 m dhe largësia bima nga bima 1.7 m, duke siguruar rreth 2178 bimë/ha. Mbjellja u realizua në gropa me përmasa 40 x 40 x 40 cm. U përdor rreth 50 kv/ha pleh organik dhe 550 kg/ha superfosfat duke e hedhur në gropë para mbjelljes. Fidanët e aronias për mbjellje ishin homogjenë, 2-vjeçarë të zhvilluara mirë dhe të shëndetshëm. Pas mbjelljes së fidanit toka u ngjesh mirë për të siguruar kontaktin e duhur të tokës me sistemin rrënjor. Mbjellja u bë në fund të shkurtit 2021 me kultivarin "Nero", blerë në Hungari. Sipërfaqja e fushës së mbjellë ishte 4500 m^2. Pas mbjelljes u instalua sistemi i ujitjes me pika për të garantuar ujitjen dhe siguruar lagështinë optimale në tokë. Më tej u tregua kujdesi i duhur për të siguruar zënien e fidanëve e cila u realizua 100 %. Toka në rreshta, në një gjerësi rreth 2 m dhe midis bimëve, u mbajt pothuajse e pastër nga barërat e këqija. Gjatë vegjetacionit u përdor vetëm pleh azotik, në formë nitrat amoni. Plehrimi u realizua në vitin e dytë dhe të tretë pas mbjelljes në dy duar, duke filluar nga mesi i muajit maj dhe plehërimi i fundit u bë në muajin qershor. U përdor vitin e tretë 350 kg/ha dhe vitin e katërt 450 kg/ha. Gjatë periudhës të kultivimit të aronias nuk kemi pasur probleme me sëmundjet dhe dëmtuesit sepse aronia është pothuajse imune në këtë aspekt. Frutat e aronias kanë nevojë afërsisht tre muaj për të arritur pjekurinë. Frutat u volën kur morën ngjyrën karakteristike të zezë. Vjelja e aronias u bë me dorë dhe me kujdes që frutat të mos plasariten. Frutat e vjelë u vendosen në arka plastike dhe u transportuan me kujdes, megjithëse aronia i reziston transportit.

3. REZULTATE DHE DISKUTIMI I TYRE

Bima filloi të japë prodhim me fruta të pakta që në vitin e parë pas mbjelljes, në vitin e dytë pas mbjelljes prodhimi mesatar varioi nga 0,2-0,3 kg/bimë, dhe në vitin e tretë pas mbjelljes prodhimi ishte 2-3 kg/bimë. Vjelja filloi në fund të gushtit dhe gjatë muajit shtator. Fruti i aronias u shit i njomë, menjëherë pas vjeljes dhe si frut i thatë. Çmimi mesatar i shitjes ka variuar nga 500 lekë/kg fruti i njomë dhe 1700 lekë/kg frut i thatë. Raporti i frutit të thatë me frutin e njomë është mesatarisht 1/3 dhe kjo lidhet me afatin e vjeljes. Tharja e frutave të aronias u bë në kushte natyrale ku 3-5 ditët e para u lanë në diell dhe më pas në hije. Shpenzimet për periudhën e studimit të aronia melanokarpa jepen në tabelën nr.1

Tabela nr.1. Shpenzimet totale për pemishten e Aronias së zezë gjatë viteve të studimit 2021-2023.

Total expenses for the orchard of Black Aronia during 2021-2023 years of study.

Shpenzimet e ngritjes së pemishtes së Aronias për 1 ha					
Nr.	**Emërtimi**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi lekë**	**Vlera në lekë**
1	Analizat e tokës	copë	1	3690	3690
2	Punimi i thellë i tokës	ha	1	30000	30000
3	Frezim	ha	1	15000	15000
4	Fidanë	copë	2178	366	797148
5	Shtylla betoni për rrethim të pemishtes.	copë	150	270	40500
6	Rrjetë teli me lartësi 1.5 m	ml	450	190	85500
7	Shpim pusi për ujë	ml	30	3000	90000
8	Pompë uji zhytëse	cpoë		31000	
9	Thithës uji me benzinë	copë	1	25000	25000
10	Tubë plastikë ujitje pikë-pikë (diametër 25 mm)	ml	4000	27	108000
11	Ventila (diametër 25 mm)	copë	40	1200	48000
12	Mbyllëse (diametër 25 mm)	copë	40	180	4800
	Piketimi	ha	1	5000	5000
14	Hapje gropa	copë	2178	50	108900
15	Mbjellje fidani	copë	2178	30	38340
16	Pleh organik	kg	4356	2.5	10890

17	Pleh fosforik	kg	545	23	12535
18	Ujitje	ha	1	15000	15000
Totali i shpenzimeve viti i parë					**1438703**
	Punimi tokës brenda rreshtit	ha	1	25000	25000
	Ujitje	ha	1	15000	15000
	Korrje e barit midis rreshtave	ha	1	10000	10000
Totali i shpenzimeve viti i dytë					**50000**
	Punimi tokës brenda rreshtit	ha	1	25000	25000
	Ujitje	ha	1	15000	15000
	Korrje e barit midis rreshtave	ha	1	10000	10000
	Plehrimi azotik	Kg	327	48	15696
	Vjelje	ha	1	20000	20000
	Transporti	kv	4.40	500	2200
Totali i shpenzimeve viti i tretë.					**87896**
	Punimi tokës brenda rreshtit	ha	1	25000	25000
	Ujitje	ha	1	15000	15000
	Korrje e barit midis rreshtave	ha	1	10000	10000
	Plehrimi azotik	Kg	435	48	20880
	Vjelje	ha	1	160000	160000
	Transporti	kv	44	500	22000
	Tharje	kg	4400	10	44000
Totali i shpenzimeve në vitin e katërt.					**296880**
Shpenzimet e përgjithëshme					**1873490**

Shpenzimet fillestare (viti i parë) ishin 1438703 lekë/ha. Shpenzimet e përgjithshme ishin 1873490 lekë. Ky shpenzim u shlye me shitjen e prodhimit të vitit të tretë pas mbjelljes. Për periudhën e shfrytëzimit pas vitit të tretë shpenzimet janë minimale. Ato varjojnë sa shpenzimet e vitit të katërt 296880 lekë/ha duke shtuar dhe procesin e krasitjes në vlerën 25000 lekë/ha që synon heqjen e degëve të dobëta, të dëmtuara, pjesët e vjetra për një ajrim dhe ndriçim të mire të bimëve në rreshta. Në total shpenzimet pas vitit të katërt shkojnë deri 321880 lekë/ha. Kostoja e 1 kg aronia shkon deri 59 lekë/kg dhe fitimi 441 lekë/kg. Efektiviteti ekonomik i kultivimit të *Aronia melanocarpa* i krakasuar me kulturat tradicionale (grurë, misër, patate, qepë, mollë me kultivim ekstensiv dhe intensiv) për zonën e studimit rezulton si në tabelën 2.

Tabela nr.2. Efektiviteti ekonomik i aronia melanocarpa (Aronia zezë) krahasuar me kulturat e kultivuara tradicionalisht në zonën e studimit. Economic efectivity of Aronia melanocarpa, compared to traditioanally cultivated plants in study zone.

Nr	Kulturat	Rendimenti mesatar kv/ha	Çmimi mesatar l/kg	Kosto në l/kg	Fitimi neto l/kg	Të ardhurat mesatare në l/ha	% krahasuar me aronian
1	**Aroni e zezë**	**54.45**	**500**	**59**	**441**	**2401245**	**100**
2	Grurë	50.0	30	23	7	35000	1.45
3	Misër	70.0	25	23.5	1.5	10500	0.44
4	Qepa	500	35	18	13	650000	27.00
5	Patate	350	35	22	13	455000	18,94
6	Mollë ekstensive	400	35	17	18	720000	29.98
7	Mollë intensive	750	43	12	31	2325000	96.82

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Bashkia Maliq 2024

4. PËRFUNDIME

Aronia (*Aronia melanocarpa* (Michx.) Ell.) përshtatet shumë mirë me tokat dhe kushtet klimatike, të rajonit të Korçës, ku u ngrit prova fushore. Eektiviteti ekonomik i kultivimit të aronias është më i lartë krahasuar me kulturat tradicionale (grurë, misër, patate, mollë etj). Të ardhurat e këtyre kulturave krahasuar me të ardhurat nga aronia të shprehura në përqindje luhaten nga 0.44 % deri 96.82 %. Shpenzimet e përgjithëshme të kultivimit të aronias u shlyen në vitin e tretë pas mbjelljes me shitjen e prodhimit të saj.

Fruti i aronias mund të thahet dhe të ruhet më gjatë krahasuar me kulturat tradicionale të kultivuara në rajonin e Korçës. Kultivimi i aronias kërkon më pak fuqi punëtore, krahasuar me disa kultura tradicionale, dhe mund të përballohet më lehtë nga një familje fermere. Kultivimi i aronias së zezë është një alterativë e re për fermerët e rajonit të Korçës. Ata mund ta shohin si mundësi kultivimin e saj, me synim për të rritur të ardhurat në fermat vogla familjare.

LITERATURA

1. Dragomir D, Dogaru M, Căliniţă C, Hoza D, Stănică F, Peticilă A G, Ion L. 2022. *Preliminary results regarding the behavior of some chokeberry cultivars (aronia melanocarpa) in organic system. Scientific Papers. Series B, Horticulture. Vol. LXVI, No. 1, 2022.*
2. Gurčík Ľ, Bajusová Z, Ladvenicová J, Palkovič J, Novotná K. 2023**.** *Cultivation and Processing of Modern Superfood Aronia melanocarpa (Black Chokeberry) in Slovak Republic. Agriculture 2023**,** Slovakia.*
3. Gurčík L; Bajusová Z; Ladvenicová J; Palkovič J; Novotná K. 2023. *Cultivation and processing of modern superfood-aroniamelanocarpa (black chokeberry) in slovak republic. Agriculture 2023, 13(3), 604; https://doi.org/10.3390/agriculture13030604; March 2023.*
4. Hoxha H. 2020. *Aronia, pemë dhe ilaç. Oxsygen press Kosovë 2020.*
5. IGJEO. 2021/2022. *Buletini mujor klimatik. Tiranë.*
6. Lupascu N, Cadar E, Cherim M, Erimia C-L, Sîrbu R. 2016. *Research concerning the efficiency of aronia melanocarpa for pharmaceutical purpose. European Journal of Interdisciplinary Studies. January April 2016 Volume 4, Nr. 1*
7. Makarenko, V,, 2008. "*Marek's juice, czyli Polska potęgą aronii." Gazeta Wyborcza.*
8. Manoku Y. 2009. *Historia e bujqësisë dhe agropërpunimit në rajonin e Korçës. Korçë.*
9. Platonova E.Y; Shaposhnikov M.V; Lee H.Y; Lee J.H; Min K.J; Moskalev A. 2021. *Black chokeberry (Aronia melanocarpa) extracts in terms of geroprotector criteria. Trends Food Sci. Technol. 2021, 114, 570–584.*
10. Q.T.T.B Vlorë. 2018 *Kultivimi i aronias. Raport vjetor*.
11. Q.T.T.B –Vlorë.2016. "*Frutikultura alternative" 5 tetor 2016* .
12. Raţi I V; Răducanu D; Bădăluţă N. 2016. *Research on the introduction of the speciesaronia melanocarpa, with a high natural value, from the spontaneous flora into organic farms. Studii şi Cercetări Martie 2016 Biologie 25/1 18-27 Universitatea"Vasile Alecsandri" din Bacău,*
13. Zdunic, G.; Alimpic-Aradski, A.; Godevac, D.; Zivkovic, J.; Lausevic Duletic, S.; Krstic Milosevic, D.; Savikin, K. 2020. *In Vitro hypoglycemic, antioxidant and antineurodegenerative activity of chokeberry (Aronia melanocarpa) leaves. Ind. Crops Prod. 2020, 148, 112328.*

14. Zielińska M, Gryglicka H, Kamil K. Hozyasz. 2023. *Chokeberry "antioxidant (oxidative damage, cancer, heart disease, diabetes, hypertention, hypercholesterolemia, treatment, prevention)"– clinical perspectives. Pediatria Polska 88 (5), Sept.- Oct. 2013,*
15. Zorba P, Salillari I, Mehmeti I. 2021. *Përshtatshmëria e tokës bujqësore në bashkinë e Korçës për disa kultura dru-frutore dhe hardhinë. Korçë 2021.*
16. Zhang Y; Zhao Y; Liu X; Chen X; Ding Ch; Dong L; Zhang J; Sun Sh; Ding Q; Khatoom S; Cheng Zh. 2021. *Chokeberry (aronia melanocarpa) as a new functional food relationship with health: an overview. Journal of Future Foods, Volume 1, Issue 2, December 2021, Pages 168-178.*

PRODHIMI BIOLOGJIK I BIMËVE MJEKËSORE-AROMATIKE DHE QËNDRUESHMËRIA E FERMAVE BUJQËSORE

Adrian MAHO
Gjergji MERO
Besnik SKËNDERASI
Sulltane AJÇE
Fakulteti i Bujqësisë
Universiteti "Fan S. Noli"

Abstrakt
Sektori i bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA-ve), është një sektor qe po rritet shpejt i ndikuar nga zgjerimi i kultivimit te këtyre bimëve. Ai ka një potencial të madh zhvillimi, gjeneron punësim të qëndrueshëm dhe është burim ekonomik për shumë familje në zonat rurale të vendit.
Rritja e kërkesës për bimë mjekësore dhe aromatike nga tregu ndërkombëtar, rrit presionin për të intensifikuar prodhimin, duke rritur rrezikun e mbi shfrytëzimit të këtyre burimeve natyrore. Prodhuesit e bimë mjekësore dhe aromatike duhet te fokusohen drejt prodhimit biologjik. Kjo është praktika më e mirë për të patur një sektor me zhvillim te qëndrueshëm. Literatura mbi praktikat e qëndrueshme në prodhimin e BMA-ve është e shpërndarë prandaj nëpërmjet këtij studimi synojmë të sigurojë një përmbledhje të praktikave bujqësore në këtë sektor. Dalja e rregullores së re të BE mbi prodhimin biologjik, kërkesat shumë rigoroze nga tregu ndërkombëtar kërkojnë zbatimin e teknikave të kultivimit dhe tregtimit në përputhje me to. Metoda e studimit bazohet në analizën SWOT të sektorit, si dhe rekomandon praktikat më të mira te prodhimit biologjik te bimë mjekësore dhe aromatike. Ekonomia rrethore konsiderohet si një nga zgjidhjet për të nxitur qëndrueshmërinë, si

pasojë e realizimit të praktikave bujqësore në miqësi me mjedisin. Studimi synon gjithashtu t'i lehtësojë prodhuesit duke iu treguar praktikën e certifikimit të produkteve bio të bimëve mjekësore dhe aromatike. Ky hulumtim mund t'i ndihmojë prodhuesit të identifikojnë mundësi të reja biznesi.
Fjalë kyçe: bimë mjekësore dhe aromatike, qëndrueshmëri, ekonomi rrethore, prodhim biologjik, certifikim.

BIOLOGICAL PRODUCTION OF MEDICINAL-AROMATIC PLANTS AND SUSTAINABILITY OF AGRICULTURAL FARMS

Abstract

The medicinal and aromatic plants (MAPs) sector is a rapidly growing sector influenced by the expansion of the cultivation of these plants. It has great development potential, generates stable employment and is an economic source for many families in rural areas of the country.

The increase in demand for medicinal and aromatic plants from the international market increases the pressure to intensify production, increasing the risk of overexploitation of these natural resources. Producers of medicinal and aromatic plants should focus on biological production. This is the best practice to have a sector with sustainable development. The literature on sustainable practices in the production of MAPs is scattered, therefore through this study we aim to provide an overview of agricultural practices in this sector. The release of the new EU regulation on biological production, very rigorous requirements from the international market require the implementation of cultivation and marketing techniques in accordance with them. The study method is based on the SWOT analysis of the sector, as well as recommending the best practices of the biological production of medicinal and aromatic plants. The circular economy is considered as one of the solutions to promote sustainability, as a result of the implementation of environmentally friendly agricultural practices. The study also aims to facilitate producers by showing you the practice of certification of organic products of medicinal and aromatic plants. This research can help manufacturers identify new business opportunities.

***Keywords**: medicinal and aromatic plants, durability, circular economy, biological production, certification.*

1. INTRODUCTION

The sector of medicinal and aromatic plants (MAP) has a great development potential, generates stable employment and is an economic source for many families in rural areas of the country. The

organic sector of agricultural production in Albania occupies a small percentage. The area of agricultural land certified as organic has had an increasing trend (Zhllima, 2020).

The demand for medicinal and aromatic plants is projected to grow annually by 10 to 12% (Chandra, and Sharma, V 2019). The high growth rates are related to the preference for natural products for health benefits, as they are considered safer and more cost-effective than synthetic pharmaceutical drugs (Bareetseng, 2022).

The increase in demand for medicinal and aromatic plants increases the pressure to intensify production, increasing the risk of overexploitation of natural resources.

About 95% of the production of aromatic medicinal plants is exported, representing almost 20% of the total agricultural exports of Albania. 70% of medicinal plant exports go to the Eurozone, while the rest, to the United States of America. The medicinal and aromatic plant sector generates around 46-55 million euros from export, listed as the second largest sector in agricultural export. Albania is part of the group of 25 leading exporters of aromatic medicinal plants in the world (AIDA, 2021).

"Organic Agriculture", which is defined by various words such as biological, ecological and bio, arose as an alternative method to overcome the negative effects of the increasing use of chemical fertilizers and pesticides on agricultural and human health and commercial problems.

Sustainable development brings the ideal harmony of simultaneous economic growth, social improvement and environmental protection.

Therefore, both consumers and companies should commit to sustainable practices (Marcelino et al, 2023). Therefore, both consumers and companies must commit to sustainable practices (Marcelino et al, 2023).

The development aims to maximize, simultaneously:

Objectives of the biological system (sustainable genetic diversity, biological productivity),

Economic objectives (satisfaction of basic needs, improvement of equity, increase of goods and useful services) and

Objectives of the social system (cultural diversity, institutional sustainability, social justice, participation).

Biological production of medicinal-aromatic plants is an important

factor accompanying the transition of conventional farmers (small or not) to organic farming or other good and sustainable agricultural practices.

Small farms from a problem in agricultural production can be transformed into good economic opportunities in the biological production of aromatic medicinal plants.

Even in the Albanian territory, there are many evidences of the modeling of the agricultural landscape, based on the criterion of establishing the relations of "symbiosis" between man and the land.

To introduce and implement the concept of sustainable agriculture, it is necessary to carry out a preliminary scientific-cultural operation, which consists in practicing ecological knowledge - i.e. the study of the system as a whole and not only of its parts in the practice of agriculture, interpreting above all the agricultural farm as an agroecosystem.

In 2015, all UN countries adopted the 2030 Agenda for Sustainable Development, which includes 17 SDGs (Sustainable Development Goal), 169 target indicators and 232 indicators.

Goal 12. Ensure sustainable consumption and production patterns

12.2 By 2030, achieve the sustainable management and efficient use of natural resources

12.4 By 2020, achieve the environmentally sound management of chemicals and all wastes throughout their life cycle, in accordance with agreed international frameworks, and significantly reduce their release to air, water and soil in order to minimize their adverse impacts on human health and the environment.

Referring to the Sustainable Development Goals in agriculture, the use of sustainable practices can reduce energy consumption by reducing negative environmental impacts (Freitas et al, 2021). Sustainable practices, such as biological production, can result in economic benefits through circular economy strategies (Braga, 2021).

Sustainable practices in the biological production of medicinal and aromatic plants (Medicinal and Aromatic Plants MAP) necessary for producer farmers and for collectors and exporters are scattered in the literature, this paper aims to provide solutions in this direction. This scientific work aims to make a contribution to the field of sustainable agriculture of biological production of medicinal and aromatic plants. Based on the existing scientific knowledge and the principles of the circular economy, we aim to implement the best practices of biological

production of BMA, safe markets for them, higher income for farmers and business of this sector and environmental protection.
The best practices are presented based on the proposals published by the World Health Organization (World Health Organization, 2003) (for medicinal plants), the European Plant Breeders' Association (EUROPAM, 2022), the new EU Organic Regulation (Reg. (EU) 2018/848, Reg. (EU) 2021/1698)
During the last years, the market and demands for medicinal and aromatic plants have changed a lot, focusing on their organic production.
Demands from foreign companies are increasing in terms of organic and certified products. Large international companies are increasingly looking for raw organic ingredients for the production of their medicines or food and beverages.
The purpose of the study is to provide expertise related to:

- ✓ The standard of organic products of medicinal and aromatic plants.
- ✓ Selection and selection of improved varieties.
- ✓ Drawing up the nutritional balance of plants without the use of chemical fertilizers.
- ✓ Designing and following biological plant protection schemes by eliminating the use of
- ✓ fungicides and herbicides.
- ✓ Techniques of biological warfare against weeds by eliminating the use of herbicides.
- ✓ Standardization of certification and labeling of organic products of medicinal and aromatic
- ✓ plants produced.

2. MATERIAL AND METHOD

The main research methods used in this study are quantitative and qualitative methods, combining primary and secondary data. The sector of production of medicinal and aromatic plants is subject to SWOT analysis. It is an audit analysis used to identify the strengths and weaknesses of this sector. SWOT is short for: Strengths, Weaknesses, Opportunites and Threats.
Primary data
They consisted in the application of interviews with farmers of the

production of medicinal and aromatic plants (MAP), production and commercial entities, in order to identify the cooperation and problems faced by actors in a supply chain. Comparing the competitiveness of conventional producers and those who implement biological production practices.

Secondary data consisting

Official data, provided by INSTAT, FAOSTAT, Ministry of Agriculture and Rural Development Albania.

Legislation:

LAW No. 106/2016, For biological production, labeling of biological products and their control.

Rregullore (BE) 2018/848 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 30 maj 2018. Për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 834/2007.

Në gramatikën e Frashërit fjala *një* nuk përmendet si nyjë joshquese, po si fjalë që mund të jetë numëror dhe përemër i pacaktuar. Në paradigmat për emëroren dhe kallëzoren e pashquar, shembujt janë me *një*: *ra një gur, e vura mbi një gur*. Gjithashtu, përdorimi i nyjës së pashquar *një* vihet re në shembujt për dallimin e rasës gjinore nga dhanorja: gjin., *maj' e një guri,* dhan., *i rashë një guri, pun' e një miku, i dhashë një miku* (1988: 118). Prania e fjalëzës *një* në këto forma rasore tregon nevojën që ka paradigma e lakimit të pashquar për të përdorur nyjën e pashquar në realizimin e kuptimit gramatikor dhe formës gramatikore të këtyre rasave.

Gramatikat e shekullit XX- XXI

Fillimshekulli XX shënohet nga gramatika e Gj. Pekmezit (1908), i cili nuk e numëron nyjën si pjesë të ligjëratës, në § 52 "Bestimmte und unbestimmte Form des Substantiv (postpositiver Artikel)" (Format

e shquara dhe të pashquara të emrit (nyja e prapme). Kur i jep emrat në njëjës e shumës të pashquar, nuk vendos para tyre *një* përkatësisht *disa*, as i përmend këto dy fjalë kur përqas format e pashquara me të shquarat. Edhe te përemrat e pacaktuar, *një* dhe *disa* i sheh vetëm si përemra (Pekmezi, 1908: 85-87). Po, teksa trajton klasën e numërorëve të gjuhës shqipe, ai shkruan se *një* përdoret shpesh në cilësinë e një nyje tek trajta e pashquar e emrit, si gjermanisht *një* + emër (1908: 85-87).

Nyjat marrin një status me rëndësi në gramatikën e I. D. Sheperit (1927) i cili e pohon funksionin e fjalës një si nyjë e pashquar në gjuhën shqipe kur shkruan se "dhe mbiemrin 'një' diku e quajnë 'nyjë të pashquar' kur përdoret jo si numëror po si përemër i pakufishëm; *një ditë më tha* fjala *një* është një nyjë joshquese ose mbiemër i pakufishëm se nuk tregon numrin e ditëve, por e bën fjalën ditë të pacaktuar" (Sheperi, I.D. 1927: 40).

Gjysmës së parë të shek. XX i takon edhe gramatika e J. Rrotës (1930). Ky autor nyjat (nejet) i trajton në kreun e dytë të pjesës së tretë "Trajtat e shqipes ase morfologjia" të librit "Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore". Ndonëse këtu nuk e përmend nyjën e pacaktuar *një,* në shënimin nr. 2 të vërejtjeve për përdorimin e nyjave thotë se "kemi edhe nenin e pashquem, *një"* Ai thekson se "kjo nyjë në gjuhën popullore dhe sipas dokumenteve të të vjetërve, merr trajta të posaçme në rasat e lakuara: *një* në rasat e drejta dhe *njëj* në rasat e zhdrejta": *Na sod kemi mbetë njëmend* ***një*** *popull i vogël, por kemi* ***një*** *histori të lavdueshme. Qe, një kokërrë voe sa grushti i* ***njëj*** *fëmije. I thashë* ***njëj*** *djali, që ndesha rrugës."* (Rrota, J. 1930: 242).

Një trajtim me interes të fjalëve përcaktuese të emrit shohim në gramatikën e S. Manit (1932) Për nyjën joshquese *një* Mani vëren se nyja joshquese *nji* është e pandryshueshme, përveçse në disa dialekte. Autori jep shembuj të emrit në rasën rrjedhore, ku në një shënim shkruan se rrjedhorja njëjës dhe shumës shfaqen vetëm në formën e pashquar: *nji shkamb mali, nji varg malesh, çaj mali, nji magazinë këpucësh* (Mann, S. 1932: 48), duke nënkuptuar kështu domosdoshmërinë e nyjës së pashquar *një* në këtë rasë.

A. Xhuvani në gramatikën e tij bën dallimin i shquar/i pashquar, por nuk e përmend nyjën joshquese *një*: " ...fjalët *mollë, faqe, vit, fik, t'mirë, e mirë* dëftejnë çdo mollë, çdo faqe, çdo fik, çdo gja të mirë që të jetë; fjalët *molla, faqja, viti, fiku, i miri, e mira* dëftejnë nji mollë, nji

faqe, nji vit, nji fik, një gjë të mirë që e dimë, që e kemi ndër mend" (Xhuvani, A. 1937: 12). Shembujt e mësipërm jepen të zhveshur nga konteksti, ku do të dilte se emri në trajtë të pashquar në disa situata nuk mund të përdoret pa u paraprirë nga nyja *një*.

Në gramatikën e O. Myderrizit (1944) nyjat pranohen si pjesë ligjërate, ato bëjnë pjesë në grupin e fjalëve të ndryshueshme ku përfshihen edhe emri, mbiemri, përemri e foja, gjithashtu ky studiues pohon edhe praninë e nyjës joshquese në shqipe. Ai thekson se nyja joshquese quhen përemrat e pakufishëm *një* e *ca* që u vihen para rasave të pashquara të emrave për të forcuar më shumë kuptimin e "paskajuem" të tyre: *nji mal, nji mali, ca male* etj. Nga nyjat joshquese, shpjegon ai, përdoret më shumë nyja *një* (nji) sidomos për rasat gjinore, dhanore të cilat pa këtë nyjë nuk përdoren (Myderrizi, O. 1944: 40).

Nyjat trajtohen gjerësisht në të dy veprat e K. Cipos "Gramatika shqipe" (1949) dhe "Sintaksa" (1952). Në veprën e parë Cipoja nuk pranon nyjë të pacaktuar për shqipen kur shkruan "Artikull a nyjë të paçquar shqipja nuk ka. Po kur e do puna, përdor numërorin 'një' duke i veshur këtij funkcionin e një nyje së paçquar, p.sh. *Na qe një herë një plak e një plakë; një punë si kjo niset një herë e mirë…* Nyja e paçquar 'një' shumës nuk ka, në rast nevoje marrim e përdorim si shumës mbiemrin e pakufishëm *ca*: *një plak - ca pleq*" (Cipo, K. 1949: 70). Mirëpo në veprën "Sintaksa" shkruan se "nyjët janë dy faresh: nyjë të çquara: -i, -u, -a; dhe nyjë të paçquara: një, ca", që e paraqitin "njerin' a gjënë në përgjithësi, dmth. si një midis shumë të tjerësh" (Cipo, K. 1952: 21-22).

Origjinën e nyjës joshquese *një* Cipoja e gjen prej të ashtuquajturit mbiemër numëror *një*. Për të dalluar numërorin *një* nga përdorimi i tij si nyjë joshquese, që bëhet, sipas Cipos, "për të vënë më mirë në dukë iden' e njësisë që përmbyll numërori themelor "një", përdorim fjalën "vetëm" dhe thomi *"vetëm një dallëndyshe kam parë, vetëm një gjuhë di»*. Ai pranon se numërori *një* "bën edhe funkcionin e nyjës së paçquar përpara emrave të paçquar: *një burr, një grua, një kalë: një burri, një gruaje, një kali*".

Po te "Sintaksa", ky autor bën dallimin edhe ndërmjet përdorimit të fjalës *një* si përemër i pacaktuar dhe si nyjë joshquese: "*Një* si përemër i pacaktuar tregon njësi të pacaktuar dhe ndërron së gjithash nga nyja joshquese *një*, se është fjalë tonike, domethënë fjalë si gjithë fjalët e tjera që janë autonome, tek që nyja e përparme *një*, e ka humbur

pavarësinë dhe ka prirje të anojë nga fjala që pason, andaj është *proklitike*. P.sh. *Pashë një* (përemër i pakufishëm) *që kish hipur majë manit e po hante mana.* Ky përemër tregon edhe diç tjetër, tregon edhe njeri e gjë në lidhje me të tjerë njerëz a gjëra të zëna ngoje më sipër. P.sh. *Të kem nevojë për dy maqina të mëdha e të shëndosha, e të të japin vetëm një dhe atë të vogël e gjysmë të shkatërruar.* Përemri *një* mund edhe të përcaktohet disi kur shoqërohet me një plotës pjese. P.sh. *Ish një nga më të shquarit punëtorë të penës.*" (Cipo, K. 1952: 34).

Gjysma e dytë e shek. XX shënohet nga gramatika më të përpunuara, me qëndrime më të larmishme, me analiza më adekuate në trajtimin e nyjave në përgjithësi, si dhe të nyjës *një* në veçanti. Më saktësisht, në vitet '70 të këtij shekulli u hartuan dy gramatika me shumë vlerë në gramatologjinë shqipe, Gramatika e Sh. Demirajt(1971) dhe Gramatika e Akademisë së Shkencave (1976).

Morfologu Sh. Demiraj në tekstin universitar "Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe" pranon se shqipja ka nyja të sprasme (shquese) dhe nyja të përparme. Te nyjat e përparme ai dallon nyjën e trajtës së pashquar *një* dhe nyjat e e përparme *i, e, të, së.*

Nyjën *një* e quan "një fjalëzë proklitike", duke i njohur vlerat e saj si element dallues i trajtës së pashquar të emrit. "Kur një emër i përgjithshëm përdoret në trajtë të pashquar të numrit njëjës, – shkruan Demiraj, – ai zakonisht shoqërohet me fjalëzën *një,* e cila si nyje e trajtës së pashquar shqiptohet e patheksuar". Emri me nyjën joshquese *një* shënon "një frymor, një send etj. të pacaktuar, dmth. cilindo nga frymorët, sendet etj. të një klase" dhe në këtë rast mund të zëvendësohet me mbiemrin e pakufishëm *çdo* a *secili,* p.sh.: **një** (= **çdo** a **secili**) nxënës…, **një** (= **çdo** a **secili**) njeri etj.; por edhe "një frymor, send, etj. të caktuar, që folësi e njeh, kurse dëgjonjësi nuk e njeh ende", p.sh.: *Dje më erdhi në shtëpi* ***një*** *shok, i cili më solli* ***një*** *libër*" (Demiraj, Sh. 1971: 53).

Autori thotë se nyja *një* përdoret në një formë të ngurosur në të gjitha rasat. Si burim të saj sheh numërorin *një,* duke pohuar se fjalëza *një* "nuk është gjë tjetër veçse numërori themelor *një,* që me kohë ka marrë edhe kuptimin e një përemri të pakufishëm" (1971:53). Më tej shkruan se: "Nyja e trajtës së pashquar *një* duhet dalluar nga numërori *një,* prej të cilit ka dalë. Kur përdoret si nyje e trajtës së pashquar, fjalëza **një** nuk shpreh ndonjë kuptim numri dhe është e patheksuar, kurse numërori themelor *një* shpreh një kuptim të caktuar numri dhe

është më i theksuar; numërori themelor **një** mund të përforcohet edhe me fjalën **vetëm**", p.sh.: Ai ka **një** nënë të mirë (nyjë), *Me **një** dallëndyshe (vetëm me një dallëndyshe) nuk vjen pranvera* (numëror) (1971:53).

Me "Morfologjinë e gjuhës së sotme shqipe" të Sh. Demirajt, që është përshkrimi më i plotë i morfologjisë së shqipes deri në fund të viteve '60 të shekullit të shkuar, mbyllet epoka 250-vjeçare e gramatikave të hartuara për qëllime didaktike dhe i çelet rruga hartimit të një gramatike shkencore të shqipes, të mbështetur mbi një platformë teorike të përcaktuar mirë. Kështu, falë punës kolektive të një grupi të gjerë morfologësh e sintaksologësh, pa dritën e botimit vepra akademike në dy vëllime "Gramatika e gjuhës shqipe", e cila është vepra e parë shkencore dhe më e plotë që merret me përshkrimin e strukturës gramatikore të gjuhës shqipe.

Gramatika akademike në kreun e parë "Njohuri të përgjithshme" nuk e përfshin nyjën si pjesë të veçantë të ligjëratës. Megjithatë, nuk mund të mos vërehet një qëndrim i lëkundur në trajtimin e nyjës *një* dhe të nyjave të tjera. Kështu, në § 42 të sythit kushtuar kategorisë së pashquarsi/shquarsisë, ndonëse flitet gjerësisht për kuptimin dhe përdorimin e trajtës së pashquar të emrit, nuk jepet asnjë shembull emri të pashquar me *një* përpara. Konkretisht, në pikën 11 të këtij paragrafi, që trajton rastet kur emri i pashquar përdoret me fjalë përcaktuese, si të tilla përmenden numërorët themelorë, por nuk jepet asnjë shembull emri të pashquar; përmenden përemrat e pacaktuar *shumë, pak, aq, kaq, ca disa, mjaft* dhe jepet shembulli ***Disa** kooperativistë po kthesheshin nga puna*, por nuk thuhet se *disa, ca* janë nyja të pacaktuara të shumësit.

Por pjesa e fundit e kreut të emrit, që përfshin paragrafët 52–54 merret me problemin e nyjave. Aty nyja "përfshihet në klasën e përcaktorëve, të cilët shërbejnë për të individualizuar", por dallon nga përemrat dëftorë, përemrat pyetës, përemrat pronorë, disa përemra të pacaktuar dhe numërorët themelorë, sepse "nuk ka kuptim leksikor të mëvetësishëm dhe është bërë kështu një fjalë shërbyese" (1976: 120). Fillimisht, të bie në sy që të gjitha këto fjalë të cilat i prijnë emrit të pashquar, quhen "përcaktorë", kur, në të vërtetë, nuk janë gjymtyrë fjalie. Në këtë paragraf thuhet se "dallohen dy lloje nyjash, nyja e caktuar ose nyja shquese dhe nyja e pacaktuar ose nyja joshquese" dhe shpjegohet se emri me nyjë shquese shënon një frymor a send plotësisht

të individualizuar si për folësin, edhe për dëgjuesin, ndërsa emri i shoqëruar me nyjën e pacaktuar nuk është plotësisht i individualizuar, pasi është i panjohur për dëgjuesin. Për këto vlera që fitojnë emrat e shoqëruar me nyjë, gramatikat e gjuhës shqipe e kanë dalluar atë "si pjesë e veçantë e ligjëratës".

Më tej, përmenden "treguesit gramatikorë që i përgjigjen nyjës shquese" (*-i, -u, -a* për njëjësin dhe *-t(ë)* për gjininë asnjanëse dhe shumësin e të tri gjinive) dhe si mjet për shprehjen e pashquarsisë pranohet nyja e pacaktuar ("si nyjë e pacaktuar shërben fjala *një*") (1976: 120).

Paragrafi 53 i kushtohet i gjithi nyjës së pacaktuar, për të cilën thuhet se "…ka dalë nga numërori themelor *një*, i cili, kur përdoret si nyjë, ose e dobëson kuptimin e të treguarit të numrit, ose gati e humbet fare dhe shkrihet kuptimisht me emrin, duke u shndërruar në një fjalë shërbyese" 1976: 122). Pranohet nyjë joshquese për njëjësin, për shumësin thuhet se shqipja nuk ka nyjë të pacaktuar. Më tej, vihen në dukje dallimi midis numërorit *një* dhe nyjës joshquese *një* që "ka një theksim të dobët" dhe ngjashmëria e numërorit me nyjën homonime për sa i përket kategorisë së gjinisë, që mungon tek të dy. Po veç këtyre,kur është nyjë *një* ka edhe kuptim sasior të dobësuar dhe në ndonjë rast,si p.sh. kur emri i pashquar është në funksionin e kallëzuesorit, nyja edhe mund të hiqet; "kur është numëror themelor", një "ka theksin e vet dhe mund t'i vihet për përforcim edhe pjesëza vetëm" ose mund t'u kundërvihet në fjali numërorëve të tjerë (bleva *vetëm* një libër; bleva një libër, jo *dy*); dhe, kur është përemër i pacaktuar, *një* nuk shoqërohet nga emri) (1976: 122-123).

Për sa i përket aspektit kuptimor, në këtë vepër vihet në dukje se nyja e pacaktuar *një* përdoret kryesisht kur emri ka kuptim të individualizuar, por edhe kuptim të përgjithësuar. Kur përdoret me kuptim të individualizuar, emri me nyjën joshquese *një* tregon një nga sendet e një klase, po pa e përcaktuar se cilin syresh, pra individualizimi nuk është i plotë. Sipas autorit të kreut të emrit, kur përdoret "në këtë kuptim nyja një afron me përemrin e pacaktuar *një farë*, duke vënë në dukje tiparet e përbashkëta të një sendi me sendet e tjera të së njëjtës fare".

Aty tregohen edhe rastet e përdorimit të emrit të pashquar me nyjën *një*: kur emri përdoret për herë të parë, duke qenë i njohur për folësin, po jo për dëgjuesin (Te praku i portës qëndronin dy hije: *një plak* dhe

një plakë.); kur emri del si kryefjalë, si kundrinë, si përcaktor në gjinore, si plotës vendi pas parafjalëve *në, nëpër, mbi, nën* (Në hajat kërceu *një* lepur. Tashti kishte në shpinë një brengë të vazhdueshme. Krisma e *një rrufeje* u duk sikur e çaut tokën dysh. Vështrimi shëtit në *një amfiteatër.);* kur është kallëzues emëror dhe i ndjekur nga një përcaktor (Lugina e Matit është *një prehje* dhe *një gëzim* i rrallë për syrin.) (1976: 121-122). Mohimi i statusit të pjesës së ligjëratës, ka bërë që përdorimi i emrave të pashquar me nyjën *një* dhe pa të, të trajtohen në mënyrë të shkëputur, gjë që nga pikëpamja metodike na duket jo e qëlluar, pasi trajtimi pranë e pranë do t'i bënte më të rrokshme për lexuesin rrethimet ku nyja *një* duhet dhe ku nuk duhet përdorur, aq më tepër po të kemi parasysh se janë të shpeshta rastet e pasigurisë të folësve, sidomos në ligjërimin e shkruar, në shkrimin e saj. Edhe në ribotimin e kësaj gramatike "Gramatika e gjuhës shqipe, I" (2002) mbahet i njëjti qëndrim dhe ndiqet e njëjta metodë e parashtruar më lart.

Çështja e statusit të nyjave është rrahur në planin teorik nga disa autorë, të cilët, në përgjithësi, pajtohen për sa u përket nyjave *i, e, të, së,* por jo për nyjën e pacaktuar *një.* Ndër këta autorë, spikatin S. Riza (2002), që i ka kushtuar kësaj çështjeje një monografi të veçantë; M. Çeliku, që këto çështje i ka rrahur në disa shkrime të tij, si dhe nga F. Agalliu e E. Hysa.

S. Riza në monografinë "Nyjat e shqipes" thotë se "shqipja bashkëkohore është e pajisur me dy lloje nyjash të një zhvillimi të pabarabartë: me nyjën *e caktuar* ose *shquese,* e cila *ngjitet prapa* emravet…; dhe me nyjën *e pacaktuar* ose *gjymsë-shquese,* e cila është e fiksuar dhe e pamungueshme për për numrin njëjës: *një (nji);* kurse e mungueshme dhe pafiksuar për shumësin: *disa, ca, do*" (Riza, S. 2002: 176).

Sipas tij, identifikimi i fjalëvet *disa, ca, do* si nyja të pacaktuara për numrin shumës apo, përkundrazi, si mbiemra të pakufishëm përbën problem në gjendjen bashkëkohore të gjuhës shqipe. Përdorimit të emrave të pashquar ai i kushton mjaft vend, duke vënë në dukje rastet kur emrat e pacaktuar dalin me nyjën *një* dhe kur dalin pa të. S. Riza flet edhe për lakimin mungesor (defektiv) të një emri të pacaktuar, duke theksuar se "një emër kryekëput i pacaktuar në shqipe mund të përdoret herë vetëm në emërore e kallëzore, herë edhe në rrjedhore; por kurrën e kurrës në gjinore dhanore", dmth. se në gjinore e dhanore të pashquar

emri nuk mund të dalë pa nyjën e pacaktuar (2002: 214)

Statusi i nyjave është cekur në disa punime të gjuhëtarit M. Çeliku. Kështu, në artikullin "Vërejtje dhe mendime mbi disa gramatika të gjuhës shqipe" (1997), lidhur me nyjat e përparme *një* e *ca*, autori i këtij shkrimi thekson se "këto fjalë shumë herë kryejnë funksione të ngjashme me ato të nyjave të përparme të shumë gjuhëve të tjera". Duke qenë se përdorimi i tyre me emrat e pashquar është i domosdoshëm për rasa të caktuara, ai e sheh këtë si "një argument për t' i konsideruar këto fjalë nyja të përparme, të cilat së bashku me mbaresat e lakimit të pashquar shprehin trajtën e pashquar të emrave në gjuhën shqipe" (Çeliku, M. 1997: 36).

Në një artikull tjetër, shkruar sërisht në kuadrin e hartimit të gramatikës akademike, Çeliku vë në dukje përdorimet kryesore të tyre me funksion dallues dhe përgjithësues, duke theksuar se "nyja ca (disa) e shumësit në gjuhën shqipe përdoret shumë më pak sesa *një* e njëjësit". Përfundimi i Çelikut për nyjat joshquese: "*një* e *ca (disa)* që shoqërojnë emrat në trajtën e pashquar, janë fjalë shërbyese dhe pavarësisht nga numri i vogël i tyre, ato mund të trajtohen si pjesë më vete të ligjëratës" (Çeliku, M. 1971: 155).

Një morfolog tjetër me ndihmesa të spikatura në trajtimin e këtyre çështjeve është F. Agalliu, i cili diskutimit të tyre u ka kushtuar disa shkrime. Në artikullin "Mbi pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe" parashtron këtë argument në kundërshtim të përfshirjes së tyre në pjesët e ligjëratës: "Ajo që ne quajmë klasë e nyjave të përparme përbën gjithë-gjithë një inventar prej katër elementesh *i, e, të* (asnj.), *të* (shumës). Kjo do të ishte edhe një provë tjetër kundër trajtimit të kësaj klase elementesh si një pjesë ligjërate më vete, sepse s'mund të mendohet një kategori e tillë që të përbëhet vetëm nga katër njësi leksikore." (Agalliu, F. 1970: 173). Në një shkrim të mëvonshëm, ai propozon që fjala *një* të trajtohet "si numëror themelor, që në disa përdorime ka fituar edhe vlerën e nyjës së pacaktuar, duke humbur edhe theksin, ose shumë-shumë konvencionalisht si nyjë…" (1988: 155).

Megjithatë, pavarësisht nga argumentet që sjellin këta autorë dhe gramatika akademike kundër pranimit të nyjës së pacaktuar *një*/*ca* (disa), autorë të tjerë gramatikash të botuara kryesisht pas daljes në dritë të gramatikës akademike i njohin shqipes nyjë të pacaktuar.

Një trajtim origjinal të mjeteve gramatikore caktuese gjejmë në veprën "Albanian Grammar" (Newmark et al, 1982)., në të cilën pjesët

e ligjëratës shqyrtohen sipas rolit që luajnë në ndërtimin e sintagmave. Autorët e kësaj gramatike vënë në dukje dallimin midis anglishtes dhe shumë gjuhëve të tjera që përdorin nyja të përparme, të cilat tregojnë se emri që paraprijnë shënon një ose disa sende të një klase të shënuar prej tij. "Nyjat, – thonë ata, – përfshihen në klasën e modifikuesve të quajtur determinantë, të cilët shërbejnë gjithashtu për të dalluar individët nga klasa së cilës i përkasin. Ndryshe nga determinantët e tjerë, nyja nuk ka kuptim leksikor të pavarur nga emri të cilit i përkasin." (Newmark et al. 1982: 120).

Autorët sqarojnë se si nyjë e pacaktuar në shqipe është *një*, por edhe determinantët *ndonjë, ca, njëfarë,* ose *disa* mund të shënojnë se referenti i sintagmës emërore së cilës i paraprijnë është i panjohur nga dëgjuesi, dmth. se emri është i pashquar.

Në gramatikën e Njumarkut tregohet se kur përdorimi i saj është i domosdoshëm. Sipas tyre, nyja e pacaktuar "përdoret kryesisht kur referenti i emrit është një individ i vetëm i paidentifikuar, por edhe kur emri ka një kuptim të përgjithësuar; në rastin e parë, emri i paraprirë nga nyja e pacaktuar *një* emërton një send midis sendeve të një klase, por identifikimi i këtij individi është i paplotë", dmth. pa treguar konkretisht se cili individ shënohet nga emir (1982: 150).

Një tjetër studiues i viteve '80, N. Resuli, i pranon nyjat si pjesë të ligjëratës teksa dallon dy lloje: *nyjën e pacaktuar* (indeterminativo) dhe *nyjën e përparme* (prepositivo). Për nyjën e pacaktuar thotë se "edhe në gjuhën shqipe përdoret numërori *një*, që është i pandryshueshëm dhe në këtë funksion të veçantë të tij i patheksuar" duke nxjerrë në pah edhe një veçori tjetër që e dallon nyjën e pacaktuar *një* nga numërori homonim (Resuli, 1985: 74-75).

Ndër gramatikat e huaja që kanë trajtuar çështjen e nyjave të shqipes është edhe "Albanische Grammatik" (Buholc&Fidler 1987). Në këtë gramatikë autorët pohojnë se në gjuhën shqipe "nuk ka nyjë si pjesë e pavarur e ligjëratës", po funksionin e saj e luajnë treguesit e trajtës së shquar, nyja e përparme dhe mjete leksikore si përemrat dhe numërorët (Buchholc&Fiedler, 1987: 198). Sa i përket nyjës *një*, autorët e shohin atë si tregues të pashquarsisë, që në kontekste dhe funksione të caktuara nuk përdoret: *Sot u duk **një** i panjohur. Nëna më qepi **një** fustan. Në hijen e manit rrinin pleq. Në pazar ka pjeshkë. Për këtë gjellë na duhet miell.* Ata numërojnë rastet kur emri përdoret në trajtë të pashquar dhe kur përdoret në trajtë të shquar (1987: 234).

Nyjat pranohen si pjesë e veçantë ligjërate edhe në tekstin shkollor "Bukuria e gjuhës, 2" të R. Memushajt. [N]ë grupin e nyjave ky autor përfshin "nyjën joshquese *një"* dhe "fjalëzat që qëndrojnë para emrit, mbiemrit e përemrit, të cilat që kanë funksione fjalëformuese e formëformuese" (Memushaj, R. 2008: 132). Po, sipas tij, "nyjë e vërtetë në shqipe është nyja joshquese", e cila shërben si mjet për shprehjen e trajtës së pashquar të emrit dhe ka trajtën *një* për njëjësin dhe *disa (ca)* për shumësin, por duke saktësuar se trajta e pashquar e emrit mund të shprehet edhe pa nyja: (***një***) *djalë* – (***disa***/***ca***) *djem*, (***një***) *letër* – (***disa***/***ca***) *letra*, (**një**) *mal* – (**disa**/**ca**) *male* (2008: 121).

Ndër studimet më të fundit për nyjën joshquese *një* të shqipes është edhe monografia e K. Topallit "*Nyjat* e *shqipes*" (2009), i cili e trajton nyjën joshquese në lidhje me numërorin, si paraardhës të saj. Sipas tij, "nyja joshquese e ka ruajtur deri në njëfarë mase kuptimin e numërorit *një*. Për këtë arsye kjo e fundit, përgjithësisht, nuk përdoret me emra të panumërueshëm" (2009:243). Topalli i njeh fjalëzës 'një' funksionin e nyjës së pashquar, ai shpreh mendimin se emrat e trajtës së pashquar që shoqërohen me nyjë joshquese përdoren në dy funksione: në funksion të pacaktuar, ku nyja joshquese ruan njëfarë lidhjeje me numërorin, p.sh. *takova një mik;* dhe në funksion përgjithësues, kur emri shoqërohet nga një përcaktor ose nga një fjali përcaktore lidhore dhe nyja joshquese ka vlerën e një përemri të pacaktuar, p.sh.: *Nga njëqen që leh, mos ki frikë; nga çdo qen, nga ai qen, nga qeni* (2009: 244).

Përfundime

Në historinë 300-vjeçare të gramatologjisë shqipe trajtimi i fjalzës një zë një vend të rëndësishëm, ai përvijohet si pjesë e zhvillimit të gjuhësisë shqiptare në përgjithësi dhe gjithashtu përfaqëson fillin e mendimit shkencor gramatikor të mjaft studiuesve shqiptarë dhe të huaj.

Duke ndjekur kronologjinë e trajtimit të fjalëzës 'një' të parashtruar në këtë punim mund të arrijmë në këto përfundime:

a. Fjalëza 'një' në gramatikat e hershme të gjuhës shqipe, shek.XVIII-XIX nuk merr vëmendje në klasifikimin e pjesëve të ligjëratës. Autorët e kësaj periudhe, edhe pse e bëjnë dallimin e emrit të shquar nga ai i pashquar, fjalëzën *një* e njësojnë me numërorin *një*, vetëm pak autorë ia njohin funksionin si nyjë e pashquar (A. Dozon).

b. Në gramatikat e gjysmës së parë të shek. XX vihet re një zhvillim i ri në analizat gramatikore: fjalëzës një i njihet funksioni si nyjë e pashquar nga disa autorë si Pekmezi, Sheperi, Myderrizi dhe Cipo, i cili bën edhe dallimin në përdorimin e nyjës një nga numërori dhe nga përemri i pacaktuar.
c. Në gramatikat e gjysmës së dytë të shekullit XX vihen re dy linja trajtimi të fjalëzës një: linja e parë, e përfaqësuar nga studiuesit që e pranojnë funksionin e saj si nyjë e pashquar në gjuhën shqipe (Riza, Demiraj, Resuli, Çeliku, Memushaj etj.); linja e dytë, e përfaqësuar pjesërisht në gramatikën akademike si dhe nga studiues të tjerë si Agalliu, Hysa, nuk e njohin statusin e fjalëzës një si pjesë ligjërate, as funksionin e saj si nyjë e pashquar. Gramatika akademike mban pjesërisht këtë linjë trajtimi duke mospërcaktuar qartë qëndrimin ndaj funksionit të saj si nyjë e pashquar.
d. Ky vështrim kronologjik mbi trajtimin e fjalëzës *një* në gramatikat e gjuhës shqipe dëshmon se fjalëza 'një' nuk ka marrë ende statusin adekuat në gjuhën shqipe, faktet gjuhësore të së cilës, siç shprehet M. Çeliku, dëshmojnë se fjalëza një është e pamungueshme në rasat gjinore e dhanore dhe, si nyjë joshquese është e krahasueshme me nyjat joshquese të gjuhëve të tjera.

Bibliografi

Agalliu, F., 1988, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Universitetit i Tiranës, Tiranë, Agalliu, F., 1970, *Mbi pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe,* Studime filologjike, 4.

Buchholc, O., Fiedler, W., 1987, *Albanische Grammatik*, Leipzig.

Cipo, K., 1949, *Gramatika e shqipe*s, Instituti i Shkencave, Tiranë

Cipo, K., 1952, *Sintaksa*, Tiranë.

Çeliku, M., 1997, *Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe,* SHBLU, Tiranë.

Çeliku, M., 1971, *Kontribut për dy probleme të morfologjisë së sotme shqipe*, Studime filologjike, 1.

Da Lecce, F., M., 1716, *Osservacioni grammaticali nella lingua albanese*, Roma.

De Rada, J., 2005, *Grammatica della lingua Albanese*, G. de Rada, Firenze, 1870, në *Opere grammaticali*, Rubbettino.

Demiraj, Sh., 1961, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë.

Dhrimo, A., Angoni, E., Hysa, E., Lafe, E., Likaj, E., Agalliu, F., Demiraj,

Sh., *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, 1976, Akademia e Shkencave e RP së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
Dozon, A., 1879, *Manual de la langue chkipe ou albanaise*, Paris, Ernest Leroux.
Frashëri, S., 1886, *Shkronjëtore e gjuhës shqip*, Dritë, Bukuresht.
Gramatika e gjuhës shqipe, I, 2002, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
Jungg, G., 1881, *Elementi grammaticali della lingua Albanese*, Scutari.
Kamarda, D., 1864, *Saggio di Grammatologia Comparata della Lingua Albanese*, *Livorno*.
Kristoforidhi, K., 1882, *Gramatikë e gjuhës shqipe sipas dialektit toskë*.
Mann, S., 1932, *A short Albanian Grammar*, London.
Memushaj, R., 2008, *Bukuria e gjuhës*, 2, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore, Podgoricë.
Myderrizi, O.,1944, *Gramatika e re e shqipes*, Gutenberg, Tiranë.
Newmark, L., Hubbard, Ph., Prifti, P., 1982, *Standard Albanian – a reference grammar for students*, Standford University Press, Standford, California.
Pekmezi, Gj., 1908, *Grammatik der albanesischen Sprache*, Wien.
Resuli, N., 1985, *Grammatica Albanese*, Patron Editore, Bologna.
Riza, S., 2009, *Vepra V*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë.
Rrota, J., 1931, *Analizimi i rasavet t'emnit e zhvillimi historik*, Shkodër.
Rrota, J., 1930, *Gramatika e shqipes*, Shkodër.
Sheperi, I., D., 1927, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë.
Topalli, K., 2009, *Nyjat* e *shqipes*, Toena.
Xhuvani, A., 1937, *Libri i gjuhës shqipe*, II, K. Luarasi, Tiranë.

NJË QASJE DIAKRONIKE RRETH TOGJEVE TË QËNDRUESHME NË GJUHËN ANGLEZE

Suela KOÇA
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti "Fan S. Noli"

Abstrakti
Ky punim paraqet një qasje diakronike për studimin e togjeve të qëndrueshme në gjuhën angleze brenda kontekstit gjuhësor të shekullit të 20-të. Këto lidhje leksikore të përsëritura në gjuhë, janë tregues të rëndësishëm të marrëdhënieve semantike dhe kulturore. Duke u bazuar në perspektiva të ndryshme teorike nga autorë të shumtë, ky studim hulumton zhvillimin e togjeve të qëndrueshme në gjuhën angleze gjatë shekullit të fundit. Përmes analizës së veprave të ndryshme që përfaqësojnë periudha dhe zhanre të

ndryshme, ne shqyrtojmë rolin e faktorëve shoqëror, kulturor dhe gjuhësor në formimin e modeleve të qëndrueshme. Për më tepër, hulumtojmë edhe ndikimin e teorive gjuhësore për të kuptuar sa më mirë dukurinë e pranëvënies së këtyre njësive. Duke sintetizuar idetë teorike me të dhënat empirike, ky punim ofron një interpretim të detajuar të mënyrës se si kanë ndryshuar këto togje të gjuhës angleze gjatë shekullit të kaluar, duke ndihmuar sado pak në diskutime më të thelluara për zhvillimin e gjuhës.

Fjalët kyçe: *lidhje leksikore, konteksti gjuhësor, marrëdhënie semantike dhe kulturore*

A DIACHRONIC APPROACH TO THE STUDY OF ENGLISH COLLOCATIONS

Abstract

This paper presents a diachronic framework for examining English collocations within the context of the 20th century linguistic landscape. Collocations, the recurrent lexical pairings in language, are vital indicators of semantic and cultural relationships. Drawing upon theoretical perspectives from numerous authors, this study investigates the evolution of English collocations throughout the 20th century. By analysing differentpieces of work, representing different periods and genres, we interrogate therole of social, cultural, and technological factors in shaping collocational patterns. Additionally, we explore the impact of linguistic theories on our understanding of collocational phenomena. By synthesizing theoretical insights with empirical data, this paper offers a thorough understanding of how English collocations have evolved over the past century, contributing to broader discussions on language evolution and change.

Key words: *lexical pairings, linguistic context, semantic and cultural relationships*

HYRJE

Studimi i togjeve të qëndrueshme është një fushë e rëndësishme e gjuhësisë që ka të bëjë me analizën e përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve të caktuara në kohë dhe zhvillimin e tyre nëpër shekuj. Qasja diakronike në studimin e togjeve të qëndrueshme synon të shpjegojë si dhe pse togje të caktuara janë përdorur në gjuhën angleze ndër vite, duke e shqyrtuar këtë dukuri sa gjuhësore edhe kuptimore në kontekstin e zhvillimit të gjuhës angleze në shekullin e 20-të. Kjo qasje na lejon një kuptim më të thellë të rrugëtimit të këtyre fjalëve dhe

shprehjeve, si edhe ndryshimet e tyre të mundshme në epoka të ndryshme.
Në këtë punim, do të eksplorojmë historinë dhe zhvillimin e disa togjeve të qëndrueshme në gjuhën angleze, duke u përqëndruar në kontekstin e shekullit të 20-të. Për këtë qëllim, do të shqyrtojmë studime të ndryshme, si dhe burime të tjera të literaturës gjuhësore, për të argumentuar përkatësinë dhe rëndësinë e një qasjeje diakronike në këtë fushë të studimit të gjuhësisë. Në fund, do të përpiqemi të sjellim një kuptim më të thellë të përdorimit të togjeve të qëndrueshme në gjuhën angleze dhe ndikimin e tyre në përshkrimin e proceseve gjuhësore në shekullin e kaluar.

SHQYRTIM LITERATURE

Dukuria e pranëvënies së fjalëve u soll në vëmendjen e gjuhëtarëve në vitet 1930 nga kontekstualisti britanik John R. Firth, i cili aktualisht popullarizoi termin "collocation" (pranëvënie, renditje) që vjen nga fjala latine *collocare* (të vendosësh bashkë, të mbledhësh ose të grumbullosh). Por shumë më herët, studime pedagogjike mbi përvetësimin e gjuhës mëmë dhe të huaj ishin marrë me këto togje. Ato konsideroheshin si bashkime fjalësh në gjuhë të cilat kujtoheshin nga folësit si "njësi të tëra" dhe që përbënin mjetet kryesore në arritjen e rrjedhshmërisë në përdorimin e gjuhës. Sipas disa studiuesve, midis të cilëve edhe Gitsaki (1966), këto togje madje janë njohur dhe studiuar edhe nga grekët e lashtë.

Në artikullin "Mënyra të kuptimit" (Modes of Meaning) Firth-i mbështeti rëndësinë e studimit të togjeve të qëndrueshme si një mjet për hulumtimin e pohimeve semantike të kuptimit në gjuhësinë përshkruese (deskriptive). Si rrjedhojë e këtij artikulli, studimi i tyre mund të klasifikohet kronologjikisht në tri periudha kryesore: 1) në vitet 1960, kur këto togje ishin studiuar teorikisht dhe probleme apo çështje të ndryshme lidhur me to ishin diskutuar; 2) vitet 1970, kur ishte sugjeruar metodologjia e studimit të tyre dhe ishin bërë disa përpjekje për t'iu afruar atyre; dhe 3) nga vitet 1980 e në vazhdim, kur rezultatet dhe arritjet e studimit të tyre filluan të shfaqen. Le të shohim më konkretisht se çfarë përfshin secila nga këto peridha në studimin e togjeve të qëndrueshme.

Në vitin 1966, Michael Halliday, John Sinclair dhe Angus McIntosh botuan artikujt e tyre mbi togjet e qëndrueshme. Pas pak do

të shohim se cilat jnë karakteristikat dhe rëndësinë e këtyre punimeve në studimin e tyre.

Duke theksuar rëndësinë e studimeve leksikore në gjuhësinë përshkruese – siç theksohet vazhdimisht nga Firth-i – Halliday-i, në "Leksiku si nivel gjuhësor" (Lexis as a linguistic level (1966), thelloi më tej studimin teorik të togjeve të qëndrueshme dhe parashtroi një sërë problemesh, p.sh. nevojën *"për të shestuar metoda të përshtatshme për përshkrimin e këtyre strukturave në dritën e një teorie leksikore që do të jetë plotësuese, por jo pjesë përbërëse e një teorie gramatikore"* (f. 148). Kështu ai e zhvilloi më tej idenë e tij që e kishte paraqitur më parë në "Kategori të Teorisë së Gramatikës" (Categories of the Theoryof Grammar (1966). Sipas Halliday-it, kjo pikëpamje ishte nënkuptuarnë njohjen e Firth-it të nivelit të togjeve të qëndrueshme të gjuhës. Megjithatë, meqë në pikëpamjen e Halliday-it kombinimet e një njësie nuk kufizoheshin vetëm në njësi pranëndenjëse, interesi i tij kryesor u bë kohezioni, një çështje më leksiko-gramatikore brenda kufijve më sintetikë të gjuhës, siç edhe është vënë re në termin "kohezioni bashkëlidhës" (collocational cohesion) (Halliday & Hasan, 1976: 287). Ky term përshkruhet kështu: *"Ky është thjesht një term për të përshkruar kohezionin që rezulton prej bashkëvendosjes dhe bashkëpërdorimit të njësive leksikore. Këto të fundit, në një mënyrë ose një tjetër, në mënyrë tipike gjenden pranë njëra-tjetrës, sepse kanë prirjen për t'u ndodhur në mjedise të ngjashme"*.

Punimi i John Sinclair-it "Fillimi i studimit të leksikut" (Beginning the Study of Lexis: 1966) është një artikull paraprak që paraqet një sfond teorik dhe probleme praktike përsa i përket studimit të togjeve të qëndrueshme me anë të kompjuterit. Pothuajse të gjitha termat teknike që përdoren sot në studimin e tyre janë përkufizuar dhe trajtuar në këtë punim: nyje (node), largësi apo hapësirë (span), kuptim formal (formal meaning), togje leksikore (lexical sets), etj. Përveç këtyre termave, Sinclair-i diskuton edhe aspekte të gjuhës – terma leksikore polimorfemike, homograf, polisemi – dhe identifikon problemin e shumëllojshmërisë së gjuhës që mund të krijojë vështirësi praktike në përdorimin e kompjuterave në përdorimin e të dhënave në studimin e togjeve të qëndrueshme.

Interesi kryesor i Halliday-it dhe Sinclair-it fokusohej në bashkimin e zakonshëm të fjalëve më të përdorshme në anglishten e kohës së tyre, kurse Angus McIntosh-i, në punimin e tij "Modele dhe

grupime" (Patterns and ranges: 1966), zgjodhi të merrej me bashkimet e pazakonta. Ai propozoi që nocioni *grupim "ka të bëjë me togje të veçanta që krijojnë një seri shembujsh të caktuar"* në lidhje me leksikun. *Grupimi* dallon nga *modeli*, që *"ka të bëjë me strukurat (ndërtimet) e fjalive që formojmë"*, nga ana gramatikore (f. 199). Punimi i McIntosh-it gjithashtu ndryshon nga ato të Halliday-it dhe Sinclair-it në atë që, ndërkohë që këta të fundit u morën me togje të zakonshme dhe mjaft të përdorshme në gjuhën e përditshme, McIntosh-i shqyrtoi rëndësinë e togjeve jo të zakonshme në gjuhën letrare.

Ajo që i bashkon këto punime është se secila prej tyre, në mënyra të ndryshme, thekson se studimi i togjeve të qëndrueshme është studimi i leksikut si një pjesë e pavarur e gjuhës. Të tre, gjithashtu, kanë argumentet e tyre plotësues për studimin e tyre. Kështu, Halliday-i prezantoi këndvështrimin e tij në studimin e leksikut, Sinclair-i e çoi më tej këtë ide duke diskutuar plotësimin e saj me anë të kërkimeve kompjuterike, dhe McIntosh-i e zgjeroi më tej idenë më punën e tij mbi togjet e pazakontë në gjuhë, një fushë me të cilën Halliday-i dhe Sinclair-i nuk u morën pothuajse fare.

Vitet 1970, periudha e dytë e studimit të togjeve të qëndrueshme, mund të konsiderohet si periudha e studimeve pilot apo eksperimentale në fushën e tyre. Dy studiuesit përfaqësues të kësaj periudhe ishin John Sinclair dhe Sydney Greenbaum.

Sinclair-i dhe grupi i tij, duke u mbështetur te bazat teorike të hedhura më parë nga Halliday-i (1966) dhe McIntosh-i (1966), filluan projektin e tyre gjuhësor për studimin e "kuptimit me anë të bashkëlidhjeve të qëndrueshme" të mbështetur më parë nga Firth-i. Ata botuan "Studime leksikore të anglishtes" (English Lexical Studies) në vitin 1970. Sfondi teorik në këtë libër (Sinclair, et al., 1970) pasoi atë të Sinclair-it (1966), por përkufizimet e termave teknike ishin më të sakta dhe më të plota se më parë. Fjala vjen, përkufizimi i togjeve të qëndrueshme në "Studime leksikore të anglishtes" ishte: *"përdorimi pranë njëra-tjetrës i dy njësive në një tekst brenda [një] mjedisi të caktuar"* (f. 15), por, në fakt, ky term ishte kufizuar vetëm te "togfjalësha të rëndësishëm", që përkufizohej si: *"përdorim i rregullt pranë njëra-tjetrës i dy njësive, në mënyrë të tillë që ato përdoren së bashku më dendur se ç'mund të parashikonte shpeshtësia e përdorimit të secilës prej tyre dhe gjatësia e tekstit ku ato mund të shfaqen"* (f. 15). Shkalla e rëndësisë së shpeshtësisë së këtyre togfjalëshave është

testuar statistikisht, dhe togjet që nuk janë njohur si të rëndësishme trajtohen si "togje të rastësishme" dhe si rrjedhim nuk janë analizuar. Në "Studime leksikore të anglishtes", Sinclair-i dhe studiuesit e tjerë i dinin që në fillim problemet e gjatësisë së tekstit si edhe kufizimet në paraqitjen në kompjuter. Përsa i përket gjatësisë së tekstit, ata pohuan se *"në mënyrë që të përshkruajmë plotësisht sjelljen e këtyre lidhjeve të madje edhe 3000 fjalëve më të përdorshme në gjuhë duhet të kemi të paktën një tekst prej miliona fjalësh"* (f. 23).

Numri i vogël i teksteve të Sinclair-it (et al.) – 135.000 fjalë të anglishtes britanike, 50.000 fjalë të anglishtes së shkruar britanike, dhe pothuajse një million fjalë të anglishtes së shkruar amerikane nga "Teksti i Universitetit të Braunit" (Brown University Text) që më vonë u njoh si Korpusi Braun – e kufizoi shumë vlefshmërinë e studimit të tyre. Megjithatë, duhet të theksojmë se vlerat e librit "Studime leksikore të anglishtes" qëndrojnë në faktin se ai ndihmoi të hidheshin bazat e metodave dhe parimeve të punës kërkimore si edhe krijoi një bazë të fortë për kërkimet studimore mbi togjet e qëndrueshme në të ardhmen.

Libri i Greenbaum-it "Togfjalësha me përforcues (specifikues) foljor në anglisht: një qasje eksperimentale" (Verb-Intensifier Collocations in English: an Experimental Approach (1970) fillon me kritika ndaj studimit të Sinclair-it (që e përmendëm më lart): *"Fatkeqësisht, studimi, siç është parashtruar në artikullin e tij [Sinclair-it], do të bazohej ekskluzivisht në pranëvendosjen lineare të njësive, dhe nuk do të përfshinte pohime sintaksore dhe semantike që shpesh janë thelbësore në trajtimin e togjeve të qëndrueshme"* (f.10). Në vend të metodës së hulumtimit të një korpusi (qoftë të folur apo të shkruar), Greenbaum-i propozoi metodën e testimit të "informatorit vendas" (native informant) që përfshin aspektet sintaksore dhe semantike të togjeve të një njësie. Nga eksperimentet e tij me informatorë, Greenbaum-i solli shembullin e përdorimit të "much" (shumë) - si përforcues (specifikues) të foljes:[1]

6

"Much" (shumë) bashkohet me një folje paraprijëse si "like" (pëlqej) në fjali mohore, por jo në fjali pohore. Kështu mund të themi (f. 11-12):

[1] Yllthi shënon një fjali jo të saktë nga ana gramatikore.

I don't like him much. (Unë nuk e pëlqej atë shumë[2]por nuk mund të themi:

**I like him much. (Unë e pëlqej atë shumë)*[3]

Megjithatë, kjo fjali e fundit bëhet e pranueshme nëse "much" (shumë) paraprihet nga një modifikues, p.sh:

I like him very / too / so much. (Unë e pëlqej atë kaq shumë)

Rezultati i Greenbaum-it është interesant dhe i vlefshëm, por përqasja e tij nuk është pa probleme, p.sh. sipas testeve të tij të bëra me informatorë të ndryshëm, "agree" (bie dakord) shfaqet në 82% të përgjigjeve pas "I entirely" (unë plotësisht) (f. 80). Megjithatë, duket se Greenbaum-i nuk mori mjaftueshëm parasysh përgjigjet nga 18% informatorët e mbetur dhe njëkohësisht nuk e bëri shumë të qartë përkufizimin e tij të "informatorit vendas". Për më tepër, kjo përqasje kufizohet vetëm në studimin e anglishtes së kohës – për arsyen e thjeshtë se është e pamundur të gjesh informatorë vendas nga shekujt e kaluar – dhe nuk mund të zbatohet për studimin diakronik të togjeve të qëndrueshme.

Që nga vitet 1980 e në vazhdim, zhvillimi i shpejtë i kompjuterave dhe gjuhësisë së korpusit e çoi shumë përpara projektin e Sinclair-it që tashmë njihet si projekti COBUILD. Korpusi i tij shumë i madh, i njohur si "Bank of English" (Fondi i Anglishtes), nuk ka ndihmuar vetëm në studimin e togjeve të qëndrueshme, por edhe në hartimin e fjalorëve.

Në fillim të shekullit të 20-të, Harold Palmer, i cili ishte ndër të parët që e studioi anglishten si gjuhë të huaj (EFL), gjithashtu vuri re prezencën e të ashtuquajturave poliglose (polyglos) ose "njësi të njohura" (known units) në gjuhë. Ai hartoi një listë prej mbi 6.000 togjesh të thjeshta të cilat i përfshiu në mësimdhënien e tij në mënyrë që studentët t'i mësonin si një njësi e vetme. I njëjti interes për njësitë frazeologjike e çoi paraardhësin e tij Albert Sydney Hornby të përfshinte informacionin rreth këtyre togjeve në fjalorë nga seria e të cilave ai filloi me "Idiomatic and Syntactic English Dictionary" (Fjalori Idiomatik dhe Sintaksor i Anglishtes) (1942).

[2]Ky është një përkthim fjalë për fjalë për të kuptuar më mirë strukturën e anglishtes. *Unë nuk e kam shumë qejf atë.,* do të ishte një përkthim më i përshtatshëm.

[3] Siç shihet, në shqip ky kombinim është i mundur edhe në fjali pohore, jo vetëm në fjali mohore si në anglisht.

Kjo prirje pedagogjike u vazhdua, në mënyrë të veçantë, nga Anthony P. Cowie, Peter Howarth dhe Michael Lewis. Ky i fundit i quan këto togje si "ishuj të besueshmërisë" (islands of reliability) së thënieve të folësve. Vitet e fundit kanë treguar një rritje të interesit në studimin e togjeve të qëndrueshme në kontekstin e mësimdhënies së gjuhëve të huaja si edhe në përpjekjet e shumta për hartimin e fjalorëve për shumë gjuhë. Kështu, mund të thuhet se këto togje dalin në pah fillimisht nga vëzhgime pedagogjike në përvetësimin e gjuhës. Një nivel i lartë i përvetësimit të tyre mund të arrihet nga folësit vetëm nëpërmjet mbajtjes mend të tyre, që duket si një privilegj vetëm për folësit vendas. Interesi pedagogjik për këto togje solli edhe një motivim të fortë për studimin e tyre, grumbullimin dhe analizën e tyre në perspektivën e mësimdhënies së gjuhës.

NJË VËZHGIM MBI PËRKUFIZIMET

Për të kuptuar më mirë termin "bashkëlidhje" – ashtu siç është prezantuar brenda kornizave të kontekstualizmit ose përshkruar në studime më të hershme gjuhësore – duhet të kuptojmë lidhjen e afërisë që ekziston midis fjalëve të një gjuhe dhe që del në pah nga shfaqja tipike e fjalëve, d.m.th, prania apo shfaqja e fjalëve në kontekst të njëra-tjetrës. Kontekstualistët pohojnë se, në karakterizimin e një fjale, konteksti i saj luan rolin më të rëndësishëm: *"Një fjalë do ta njihni nga fjalët e tjera që e shoqërojnë!"* (Firth; 1957, f. 179) Më herët Charles Bally (1909) përdori shprehjet "togfjalësha të zakonshëm" (usual phrases) për t'iu referuar fjalëve që tregonin një farë afërie për njëra-tjetrën ndërkohë që ruanin autonominë e tyre (1951, f. 70-72). Për të përshkruar këtë lloj lidhjeje afërie, Eugenio Coseriu (1967) më vonë përdori metaforën "solidaritet leksikor" (lexical solidarity).

Kjo lidhje afërie leksikore nuk mund të njehsohet nga proceset rregullatore të gjuhës meqë nuk mund të shpjegohet mbi bazat e rregullave të gramatikës të zbatuara te kategoritë e fjalëve. Ashtu si thekson edhe Igor Mel'čuk *[frazema – në veçanti togjet e qëndrueshme] nuk mund të ndërtohen (...) nga fjalë ose togfjalësha më të thjeshtë sipas rregullave të përgjithshme të [gjuhës], por duhet të ruhet dhe të përdoret si një e tërë"* (1998).

Ndërkohë që karakterizimi me anë të lidhjes së afërisë ndihmon në të kuptuarit e konceptit të këtyre togfjalëshave, këto përkufizime mbeten mjaft të paqarta, sepse asgjë nuk është thënë për statusin dhe

tiparet e tyre gjuhësore. Duke mos pasur një përkufizim të saktë, termi "bashkëlidhje" gjatë gjithë kohës është ngatërruar dhe është përdorur në vende të ndryshme për të treguar dukuri të ndryshme gjuhësore. Kështu Jens Bahns-i thekson se *"ky term përdoret dhe kuptohet në shumë mënyra të ndryshme"* (1993, f. 57). Pavarësisht nga shumëllojshmëria e pikëpamjeve të ndryshme, është e mundur të përcaktohen dy perspektiva kryesore në konceptin e togjeve të qëndrueshme: një që është thjesht statistikore dhe një tjetër që është më e motivuar nga ana gjuhësore. Tani do të vëzhgojmë disa nga përkufizimet më përfaqësuese të secilit grup me radhë.

Qasja Statistikore

Përkufizimet pedagogjike dhe kontekstualiste të përmendura deri tani nënkuptojnë një element statistikor. Në mënyrë që të përvetësohen nga folësit nëpërmjet mbajtjes mend si një njësi e vetme, togjet e qëndrueshme duhet të identifikohen mbi bazat e shpeshtësisë së tyre – që do të thotë, ato duhet të gjenden pranë shumë herë që të mund të perceptohen si kombinime të zakonshme fjalësh. Në mënyrë të ngjashme, në kontekstualizëm këto togje përshkruhen në bazë të bashkëndodhjes tipike të fjalëve, ose si fjalë që tregojnë *"prirjen për t'u gjendur apo përdorur së bashku"* (Sinclair; 1991, f. 71). Nocionet e shpeshtësisë, tipizimit ose prirjes u referohen tipareve që modelohen në statistikë.

Në fakt, shumica e përkufizimeve adaptojnë një pikëpamje statistikore. Megjithëse dukuria e përshkruar ka një konotacion gjuhësor të fshehur, aspektet gjuhësore shpesh injorohen; kështu, si rezultat, në qasjet e pastra statistikore përkufizimet pothuajse gjithmonë jepen ekskluzivisht në terma statistikorë. P.sh. Firth-i (1957) jep këtë përkufizim: *Togjet në të cilat gjendet një fjalë e dhënë janë pohime të vendeve të zakonshme të asaj fjale* (f. 181).

Në shembujt që ai sjell mund të gjejmë çifte si *night (natë) – dark (e errët), bright (e ndritshme) – day (ditë),* ose *milk (qumësht) – cow (lopë)* (f. 196). Siç mund të shihet, të kuptuarit e konceptit në kontekst është sumë i gjerë, pasi përveç lidhjeve sintagmatike që vërtet mund të ndërtojnë njësi frazeologjike (tofjalëshore) – *dark night (natë e errët)* dhe *bright day (ditë e ndritshme)*, kemi edhe lidhje josintagmatike si *milk – cow* që janë të motivuara semantikisht.

Në pamundësi të Bullgarisë për të vazhduar luftimet, filluan bisedimet për paqe në Bukuresht. Sipas klauzolave të Traktatit të Bukureshtit, të përfunduar në mesin e gushtit 1913, Bullgaria u detyrua të dorëzojë thuajse të gjitha territoret, për të cilat dhjetëra mijëra qytetarë të saj kishin flijuar jetën. Adrinopoja u bë Edrene, duke u kthyer në duart e turqve pas tre muajsh. Rumunët kishin pushtuar Dobruxhën Jugore. Maqedonia u nda në tri pjesë të pabarabarta: Greqisë, i kaloi Maqedonia e Egjeut 50%, Bullgaria mori Maqedoninë e Pindit 10% ndërsa Serbia Maqedoninë e Vardarit që përbënte 40% të territorit. (Lory, 2007, p. 58) Ky traktat e la Bullgarinë të zemëruar e të grabitur nga ato që mendonte se i përkisnin. Përsa kohë qëndronte Traktati i Bukureshtit, çdo paqe në Ballkan ishte e pamundur. Shtetet e pakënaqura nga përfundim i luftrave ballkanike, Bullgaria dhe PO të nxitura nga hakmarrja, do të bashkoheshin me cilindo bllok që plotësonte interesat e tyre territoriale. (Lory, 2007, pp. 247-248)

Pasojat e luftrave ishin të mëdha, ku përveç ndryshimeve territoriale sidomos në dëm të Shqipërisë dhe Maqedonisë, kishte humbje të mëdha në aspektin njerëzor. Në dhjetë javë luftime, u vranë rreth 200 000 luftëtarë pa llogaritur civilët. Përveç tyre, dhjetra mijëra ranë viktima të kolerës, tifos dhe dizanterisë. (Glenny, 2000, p. 229) Lufta shkatërroi ekonomikisht popujt dhe solli rritjen e varësisë së vendeve të Ballkanit prej Fuqive të Mëdha, ndaj të cilave kishin marrë borxhe të shumta. Përsa i'u përket shqiptarëve, statusi i tyre u ngrit nga autonomia në pavarësi por me një territor të cunguar sepse ishin lënë jashtë Shqipërisë, Kosova, Çamëria, trevat shqiptare në Maqedonisë

perëndimore dhe trevat shqiptare në Mal të Zi.

Greqia megjithëse ishte zgjeruar territorialisht në përfundim të luftrave ballkanike nuk kishte hequr dorë nga pretendimet territoriale në drejtim të territoreve jugore të Shqipërisë. Diplomacia dhe forcat ushtarake greke u hodhën në veprim. Duke ndjerë edhe qëndrimin përgjithësisht dashamirës të Fuqive Europiane, ajo deklaronte se do të largohej nga Shqipëria e Jugut vetëm pas rezultateve të një plebishiti. (Dushku, 2012, pp. 193-194)

2. Pozicionimi i shteteve ballkanike gjatë Luftës së Parë Botërore

Mosmarrëveshjet dhe pakënaqësitë e luftrave ballkanike do ti hidhnin vendet e Ballkanit në gjirin e Fuqive të Mëdha, me shpresën për të realizuar aspiratat e lëna përgjysëm nga koha e luftrave ballkanike. Ballkani ishte rajoni prej nga ku nisi flaka e konflikti botëror. Më 28 qeshor 1914 në Sarajeve u vra duka Franc Ferdinand trashëgimtar i fronit austro-hungarez. Pas vrasjes së tij, Austro-Hungaria i vendosi një ultimatum Serbisë. Ultimatumi ishte parashikuar që të refuzohej, por qeveria serbe u përpoq që të shmangte luftën dhe i pranoi të gjitha kushtet me përjashtim të pjesëmarrjes së zyrtarëve habsburgas në hetimin e vrasjes në Serbi. Pasi ultimatumi nuk u pranua plotësisht, me 28 korrik të atij viti filloi lufta. (Schevill, 2006, p. 395)

Shtetet ballkanike e panë luftën si një mundësi për të përmbushur qëllimet e tyre territoriale, të paplotësuara nga dy luftrat ballkanike dhe nuk i kushtuan asnjë rëndësi pasojave që sjellin luftrat. Shqetësimi i tyre i vetëm ishte se cili bllok do ta fitonte luftën. Dy blloqet e mëdha ndërluftuese, hynë në negociata me Greqinë, Bullgarinë, Rumaninë, ndërkohë në Shqipëri u futën trupa ushtarake të disa shteteve duke shkelur asnjëanësinë e deklaruar të saj.

Antanta formuloi një politikë me anë të së cilës ajo i jepte Serbisë territore në Shqipërinë e Veriut me mundësinë e një daljeje në det, si kompensim të territoreve që i jepeshin Bullgarisë në Maqedoni. Një rol të rëndësishëm në këto negociata i'u dha Greqisë, e cila sipas diplomatëve të Antantës, përbënte bërthamën e çdo skeme të suksesshme. Nëse sigurohej mbështetja greke, mbështetja bullgare do të vinte krejt natyrshëm (Gay, 2012, p. 124). Pavarësisht mendimit të diplomatëve të Antantës, arritja e marrëveshjeve me shtetet e Ballkanit rezultoi të ishte e vështirë. Edhe në kuadrin e një lufte botërore, këto

vende vazhdonin të udhëhiqeshin në politikën e tyre të jashtme nga pretendimet që kishin gjatë luftrave ballkanike. Tek shtetet ballkanike, marrja e territoreve të reja ishte parësore, ndërsa lëshimi ose shkëmbimi i territoreve nuk ishte një temë që mund të negociohej.

Qëllimi i qeverisë bullgare ishte rimarrja e Maqedonisë të cilën ajo nuk kishte mundur ta merrte gjatë luftrave ballkanike. Gjithashtu ajo donte të merrte edhe Dobruxhën e Jugut të cilën i'a kishte marrë Rumania gjatë këtyre luftrave. Për shkak të pozicionit gjeografik ajo kishte çfarë t'u ofronte të dy palëve. Po të bashkohej me Fuqitë e Qendrës, ata do të kishin një front solid që nga Gjermania deri në PO. Nga ana tjetër po të bashkohej më fuqitë e Antantës, Bullgaria mund të luante një rol të madh në fushatat në Dardanele dhe Galipoli. Në rastin e Bullgarisë aleatët ishin në pozita më të dobëta sepse pretendimet e Bullgarisë cënonin Serbinë e cila ishte aleatja e vetme e Antantës në këtë kohë në Ballkan. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006)

Si mbreti Ferdinand edhe qeveria bullgare kishin simpati ndaj fuqive të Bllokut Tripalësh. Njerëzit ishin të ndarë. Ata vërtet përkrahnin marrjen e Maqedonisë, por kishin në mendje tmerret e luftrave ballkanike dhe nuk ishin të gatshëm për një luftë të re. Aleatët ishin të gatshëm që t'i lëshonin Bullgarisë territoret në jug të vijës Kriva, Velesh, Ohër, por me kushtin që Serbia të merrte Bosnje-Hercegovinën. Ata ranë dakort që kufiri jugor i Bullgarisë të shtrihej në vijën Enos-Midia afër Stambollit. Por me këtë propozim nuk ra dakort qeveria e Serbisë e cila mbajti këtë qëndrim deri në shtator 1915. Në këtë kohë situata e Serbisë u përkeqësua por përsëri ra dakort të lëshonte vetëm gjysmën e territorit për të cilin flitej. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006, p. 266)

Ndërkohë, diplomacia e Fuqive Qëndrore nuk qëndronte duarkryq të cilët i ofruan Bullgarisë kufijtë e Traktatit të Shën Stefanit. Në këto kushte në shtator 1915 Bullgaria pranoi ofertën e shteteve gjermane. Në 14 tetor nisi një mësymje e madhe e ushtrive austro-gjermane kundër Serbisë ndërkohë që ajo u sulmua edhe nga Bullgaria. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006) Në të njëjtën kohë Antana zbarkoi në Selanik 4 divizione me shpresë për ti ardhur në ndihmë Serbisë, dhe u bënë përpjekje për të futur Greqinë në luftë, por pa sukses. Italianët zbarkuan në dhjetor rrreth 30 mijë trupa ushtarake në Vlorë. Serbia nuk mund të rezistonte më, në fund të nëntorit ushtria serbe kaloi përmes Kosovës duke u tërhequr drejt portit të Durrësit.

Rumania ngurronte të hynte në luftë. Aty ekzistonte një ndarje midis palëve. Mbreti dhe një grup i vogël por me ndikim politikanësh përkrahin futjen e Rumanisë përkrah Fuqive Qëndrore. Ion. I. C. Brătianu, kryeministër i vendit, shumica e politikanëve dhe opinionit publik mbështesin Antantën. Qëllimi i përbashkët i rumunëve ishte bashkimi në një shtet, sepse pothuajse gjysma e rumunëve në vitin 1914 jetonin jashtë Rumanisë. Rumania kishte dy rajone të mëdha interesi, Transilvaninë dhe Besarabinë dhe dy më të vogla Bukovinën dhe Banatin. Tre nga këto krahina ishin nën kontrollin e Austro-Hungarisë dhe një nën kontrollin e Rusisë. Bratianu ishte i aktiv për të përfituar nga çdo mosmarrëveshje me aleatët për politikën e Ballkanit. (Spector, p. 55)

Kështu vetëm duke qëndruar neutrale Rumania në varësi të krahut që fitonte merrte një krahinë. Por në Rumani ekzistonte edhe frika se duke mos shpallur luftë kundrejt asnjërës palë, kur të vinte paqja Rumania mund të mbetej duarthatë. Kjo dilemë por sidomos edhe kundërsulmi rus i verës së 1916 i cili bombardoi pozicionet e ushtrisë austro-hungareze duke i detyruar të tërhiqeshin në rrëmujë, bëri që rumunët të futen në bisedime me Antantën dhe lidhën një marrëveshje sekrete e cila u siguronte gjithë Transilvaninë dhe një pjesë të Bukovinës që kishte në shumicë popullsi rumune. (Glenny, 2000, p. 341) Në këto kushte Rumania ra dakort që të lejonte furnizimet ruse drejt Serbisë nëpërmjet territorit të saj duke humbur kështu neutralitetin e saj.

Më 26 gusht 1916 vendi hyri në luftë kundër monarkisë së dyfishtë, por Rumania kishte pritur shumë. Gjermania në këtë kohë transferoi 15 divizione nga perëndimi drejt lindjes, duke mundur deri në fund të vitit ushtritë rumune ndërkohë që qeveria e saj u shpërgul në Moldavi. Fuqitë Qëndrore zotëronin 2/3 e vendit së bashku me burimet e naftës dhe furnizimet e drithit. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006, p. 269) Fundi i vitit 1916 e gjeti Antantën në pozitë të vështirë në të gjithë frontet. Rusia kishte humbur terren në lindje, Bullgaria në Ballkan ishte bashkuar me Fuqitë Qëndrore. Serbia ishte mundur dhe ofensiva në Galipoli kishte dështuar. Humbjet ushtarake e detyruan qeverinë rumune të nënshkruante një armëpushim me Fuqitë Qëndrore në dhjetor 1916, dhe pse në kundërshtim me këshillat e aleatëve që kërkonin që ushtria rumune të tërhiqej drejt Rusisë Jugore. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006)

Shteti i fundit ballkanik që u përfshi në LIB ishte Greqia. Kjo vonesë u shkaktua nga përplasjet e brendshme të cilat ishin shumë më të ashpra sesa në vendet e tjera ballkanike. Mbreti Kostandin ishte kunati i perandorit gjerman dhe nuk e fshihte dëshirën që të ishte krah e Fuqive Qëndrore. Kryeministri Eleftherios Venizelos, parashikoi se futja në luftë e Greqisë në anën e Antantës ishte një mundësi sepse me ndihmën e tyre pas fitores së luftës Greqia mund të përmbushte kërkesat e saj territoriale. (Gardikas-Katsiadakis, Helen Thanos Veremis, 2006) Kur më 7 shtator 1915, Bullgaria nënshkroi një marrëveshje me Fuqitë Qendrore dhe Venizelos e ashpërsoi më tej përballjen e tij me mbretin. Më 22 shtator ai denoncoi praktikën e Kostandinit i cili sipas Venizellos kishte injoruar parlamentin në çështjet e politikës së jashtme. Më 23 shtator Bullgaria mobilizoi forcat e saj dhe Venizellosi u përgjigj mos-gatishmërisë së mbretit për mobilizimin e Greqisë duke nxjerrë vetë një dekret. (Gardikas-Katsiadakis, Helen Thanos Veremis, 2006, p. 120) Aleatët e nxitën Greqinë përsëri të sulmonte Bullgarinë.

Përplasjet e brendshme politike nuk lejuan që Greqia të pozicionohej në krah të njërit prej blloqeve ndërluftuese deri në maj të vitit 1917 kur Londra dhe Parisi, vendosën të përfundojnë punën. Mbreti duhej të largohej, Venizelos duhet të ri-kthehej në Athinë dhe Greqia të bashkohej me Antantën. Qeveritë e Antantës i deleguan marrëdhëniet e tyre me Athinën tek një Komisioner i Lartë, administratori francez Charles Jonnart. Më 11 qershor ai i paraqiti një ultimatum Aleksandër Zaimis kryeministër i mbretit, duke kërkuar largimin e Kostandinit me pretekstin se ai kishte shkelur Kushtetutën. Aleksandri, në moshën 23 vjeç, u lejua të merrte vendin e babait të tij. Të nesërmen Kostandini dhe familja e tij u larguan nga Athina për në Zvicër. (Dalby, 2011, p. 65) Atëherë edhe Venizellosi u kthye në Athinë. Në qershor të 1917 Greqia hyri në luftë në krah të aleatëve.

3. Vendimet e Konferencës së Paqes në Paris për Ballkanin dhe ndryshimet territoriale e politike në rajon

Në përfundim të LIB, vendet e Ballkanit aleate të Antantës u përgatitën për të korrur frytet e fitores, ato humbëse i varën shpresat tek 14 pikat e shpallura nga presidenti amerikan Woodrow Wilson dhe nga Konferenca e Paqes në Paris. Forcat gjermane në fund të muajit nëntor ishin larguar nga Rumania. Më 1 dhjetor mbreti Ferdinand u kthye si

triumfator në kryeqytetin e tij. (Hitchins, 2011, p. 84) Ai riemëroi në krye të qeverisë Brătianun i cili kishte pritshmëri të larta për kushtet e paqes dhe shpresonte të përmbushte ambicjet e Rumanisë, madje priste që të trajtohej si i barabartë nga Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Paqes. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006, p. 281)

Rumunët ishin aktive në Konferencën e Paqes. Brătianu mendonte ti vuloste në Paris fitoret e vendit të tij. I vetëdijshëm për vendin e tij në histori dhe për përgjegjësinë solemne të detyrës që mbante, Brătianu ishte i vendosur të merrte të gjitha territoret e premtuara në traktatet e 1916-ës. Ambiciet e tij ishin në kundërshtim me synimet e Fuqive të Mëdha për të vendosur një rend të ri ndërkombëtar dhe për të përmbushur qëllimet e tyre territoriale dhe strategjike. Bratianu gjithashtu u përball me rivalitetet historike dhe pretendimet territoriale të fqinjëve të Rumanisë, Hungarisë dhe Rusisë, Serbisë dhe Bullgarisë. (Hitchins, 2011, p. 86)

Si pasojë e disfatave të dy fuqive të mëdha, Austro-Hungarisë dhe Rusisë, për Rumaninë u krijua mundesia për t'u zgjeruar territorialisht, pasi ushtritë e saj gjendeshin në territoret që pretendonte dhe aleatët e Antantës ishin të ndarë në qëndrimet e tyre. Në Rusi kishte ardhur në fuqi një qeveri bolshevike të cilën fuqitë perëndimore e shihnin me mosbesim. Jo vetëm kaq, por edhe në Hungari qeveria e udhëhequr nga Bela Kuni kishte prirje të ngjashme me qeverinë ruse. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006)

Këto ngjarje avantazhonin Rumaninë e cila pretendonte të luante rolin e vendit që po mbronte Europën nga komunizmi. Pasi kishte aneksuar territoret që pretendonte, duke shfrytëzuar edhe situatën e vështirë dhe përplasjet e brendshme politike të Hungarisë, më 19 mars 1919 ushtria rumune hyri në Hungari dhe më 4 gusht pushtoi Budapestin. Si shpërblim rumunët kërkuan që Hungaria të dorëzonte gjysmën e flotës lumore dhe vagonave. (Rothshild, 2004, p. 153) Aleatët reaguan ashpër madje përfaqësuesi amerikan propozoi që flota aleate të dërgohej për të përmbajtur Rumaninë.

Bashkimi i Rumanisë me Besarabinë u sanksionua nga Fuqitë kryesore Aleate, Anglia, Franca, Italia, Japonia dhe Rumania, me anë të Traktatit të Parisit, të nënshkruar më 28 tetor 1920. Art. 1 përcaktonte që "*Palët e Larta Kontraktuese njohin sovranitetin e Rumanisë mbi territorin e Besarabisë*". (Ion M. Anghel, 2016, p. 46) Territori tjetër i pretenduar nga Rumania ishte Transilvania të cilën ajo e pushtoi. Kufiri

me Hungarisë, u vendos me Traktatin e Trianonit më 4 qershor 1920, i lidhur midis Fuqive Aleate dhe mike përfshirë Rumaninë nga njëra anë, dhe Hungarinë nga ana tjetër. Art. 27 i këtij Traktati përcaktonte: *"Hungaria heq dorë në favor të Rumanisë për të gjitha të drejtat dhe titujt e saj mbi tokat e ish-monarkisë Austro-Hungareze, të vendosur përtej kufijve të Hungarisë"*. (Ion M. Anghel, 2016, p. 42) Në Transilvani dhe në Besarabi popullsia lokale me anë të plebishiteve u shpreh në favor të bashkimit me Rumaninë.

Me një sipërfaqe prej 28.523 km² dhe një popullsi prej rreth një milion e gjysmë, në Banat, rumunët përbënin rreth 37.4% të popullsisë së përgjithshme, gjermanët 24.5%, serbët me 18% dhe hungarezët ishin 15.3%. Brătianu kërkoi Banatin bazuar në kritere etnike duke pretenduar se rumunët ishin kombësia më e madhe në rajon. Ai gjithashtu risolli në vëmendje traktatin sekret të gushtit 1916, traktat që e kishte futur Rumaninë në LIB në anën e Antantës. Traktati i kishte premtuar qeverisë rumune tërësinë e Banatit, Transilvaninë, Bukovinën. (Haynes, 2005, p. 100) Kërkesat e tij nuk u miratuan nga Konferenca pasi marrja komplet e Banatit rrezikonte Beogradin, nga një sulm rumun prandaj aleatët lejuan pushtimin e qarkut Torontal nga serbët, territor që përbënte dy të pestat e sipërfaqes së Banatit. Hungaria mori një pjesë të vogël të Banatit, ndërsa tre të pestat iu dhanë Rumanisë. Ndarja e Banatit la rreth 75,000 rumunë në Mbretërinë SKS dhe rreth 65,000 serbë u lanë në Rumuni. (Haynes, 2005, p. 101) Zgjidhja e ndarjes nuk u aplikua në Transilvani me Hungarinë ku Traktati i Trianonit la gati 1.3 milion hungarezë në Rumani.

Politikanët serbë i'u futën punës për krijimin e "Serbisë së Madhe" ku u kuptua se fitorja ishte në anën e tyre. Më 20 korrik të 1917 u nënshkrua Deklarata e Korfuzit midis përfaqësuesit të "Komitetit Jugosllav" Ante Trumbiç, dhe kryeministrit të qeverisë mbretërore serbe Nikolla Pashiç, e cila përcaktonte bashkimin e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve. Në këtë deklaratë theksohej se shteti i ardhshëm do të ishte një monarki kushtetuese parlamentare me në krye dinastinë e Karagjorgjeviçëve dhe u quajt "Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve" (më tej SKS). (Pavlovic, 2017, p. 1036)

Në Zagreb, Këshilli Kombëtar i kroatëve, serbëve dhe sllovenëve deklaroi pavarësinë nga Monarkia e Habsburgëve dhe krijimin e "Shtetit të Sllovenëve, Kroatëve dhe Serbëve". Hapi tjetër nuk ishte i qartë, nëse ata do të rrinin të pavaruar apo do ti

bashkangjiteshin Serbisë. Në përbërjen e shtetit, u futën përveç Kroacisë e Sllovenisë edhe Bosnjë-Hercegovina. Ante Trumbici dhe përkrahësit e tij parapëlqenin një federatë, por një numër i madh kroatësh kërkonin pavarësinë e plotë. (Macmillan, 2006, p. 148) Dallimet midis qeverisë serbe dhe Komitetit Jugosllav i'u komunikuan fillimisht francezëve dhe më pas qeverisë britanike, por aleatët nxitën Trumbicin dhe Pashiqin, se ata të dy duhej të bënin një marrëveshje. (Pavlovic, 2017, p. 1039)

Në terren ngjarjet po ecnin me shpejtësi. Trupat serbe pushtuan Malin e Zi dhe një kuvend i zgjedhur votoi në favor të bashkimit më Serbinë. Edhe në Zagreb, Këshillin Kombëtar e zuri paniku, sepse mungonte rregulli dhe trupat italiane po pushtonin portet kryesore. Më 25 nëntor Këshilli vendosi ti kërkonte Serbisë bashkimin. (Macmillan, 2006, p. 149) Si pasojë, më 1 dhjetor 1918, në Beograd, në prani të përfaqësuesve të Mbretërisë së Serbisë, të "Veçes Qendrore Popullore" të Zagrebit, të Skupshtinave të Malit të Zi dhe të Vojvodinës, u shpall formimi i "Mbretërisë i SKS". Në përbërjen e tij u futën përveç Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë, Bosnje-Hercegovinës edhe Mali Zi, Vojvodina, Maqedonia e Kosova. (Pavlovic, 2017, p. 1040)

Vendimi i 1 dhjetori 1918 për të zgjedhur një bashkim të pakushtëzuar, u bë kryesisht nga frika se statusi i përkohshëm i pranisë italiane në Adriatik mund të shndërrohej në të përhershëm. E vetmja mënyra për ta parandaluar këtë, ishte pjesëmarrja në Konferencën e Paqes, me një delegacion të bashkuar. Sidoqoftë, gjatë Konferencës së Paqes, delegacionet nga të dy pjesët e mbretërisë së re duhej të përdornin të gjithë kapacitetet e tyre në qëllim për të mbrojtur interesat territoriale të sllovenëve, kroatëve dhe serbëve, që dikur jetonin në të Austro-Hungari. (Pavlovic, 2017, p. 1046) Më 20 dhjetor u formua qeveria e parë e shtetit SKS, me liderin e Partisë Radikale Serbe S. Protiç, si kryeministër dhe zëvendës A. Koroshec dhe ministër të punëve të jashtme Trumbiç. Shteti SKS u bë shteti më madh ballkanik pas LIB. Pavarësisht zgjerimit të madh territorial, orekset e klasës politike serbe e cila dominonte në këtë shtet nuk u shuan, por ato vazhduan një politikë agresive në drejtim të fqinjëve sidomos të Shqipërisë.

Bullgaria ishte aleate e fuqive që humbën luftën. Në shtator 1918 ushtria e saj kapitulloi. Fqinjët e saj triumfatorë, u përpoqën ta dobësonin sërish atë. Rumania kishte trupa në kufirin verior dhe po

përgatitej për të lëvizur në jug. Greqia po grumbullonte trupa në kufirin jugor të Bullgarisë dhe po ankohej për krimet bullgare. Serbia po tregohej më e matur por qëllimet e saj ishin më të mëdha. Aty kishte njerëz që ushqenin idenë e një bashkimi me Bullgarinë. (Macmillan, 2006, p. 171) Nga ana e tyre bullgarët e pritën me optimizëm, Konferencën e Paqes që po mbahej në Paris. Në fakt Bullgaria u thirr vetëm për të firmosur atë që kishin vendosur Fuqitë Aleate.

Bullgarët u thirrën në 19 tetor 1919 në Paris për të dëgjuar kushtet e traktatit të cilat ishin më këqija sesa ata kishin pritur. Ata kërkuan dhjetë ditë, gjatë të cilave përgatitën përgjigjen e tyre. Ankesat e tyre u dëgjuan në 24 tetor. Pika kryesore e mbrojtjes ishte që Bullgaria kishte ndryshuar dhe tani ishte një vend paqësor dhe demokratik, por kjo pati një efekt të vogël. Disa ndryshime u bënë në klauzolat financiare dhe aleatët pranuan argumentin bullgar se disa nga dispozitat në lidhje me pakicat ishin përfshirë tashmë në kushtetutën bullgare. Sidoqoftë, në përcaktimet territoriale dhe ushtarake, aleatët nuk ndryshuan qëndrim. Delegacioni u kthye në Sofje, ku kryeministi Georgi Todorov njoftoi se nuk mund të vendoste emrin e tij në një traktat të tillë dhe dha dorëheqjen si kreu i delegacionit bullgar. (Crampton, 2019)

Mbreti i ri, si edhe shumë të tjerë, kuptuan se Bullgaria nuk ishte në gjendje të rezistonte dhe se nuk kishte alternativë përveç të pranonin kushtet. Aleksandar Stamboliski mori vendimin e guximshëmtë kthehej në Paris dhe të nënshkruante traktatin për t'i dhënë fund asajlufte që ai e kishte kundërshtuar dhe ishte burgosur për këtë veprim. (Crampton, 2019, p. 60) Me Traktatin e Nejit, Bullgaria kishte humburtë drejtën jo vetëm mbi tokat e pushtuara gjatë luftës por edhe disa provinca që ajo i zotëronte në peridhën e para luftës. Provincat Caribrod dhe Strumnica ju dhanë "Mbretërisë, SKS", pjesët jugore të fushës së Dobruxhdës, Rumanisë, Traka Perëndimore kaloi nën kontrollin e Greqisë. Bullgaria në LIB humbi 8 % (10.750 km2) të territorit të para luftës. Përveç kësaj në marrëveshje ajo kishte pranuarqë të paguante reparacione në vlerë 2,25 miliard franga ari. (https://www.britannica.com/place/Bulgaria/World-War-I)

Në përfundim të LIB Shqipëria vazhdonte të ishte e pushtuar. Trupat austo-hungareze u larguan, por vendin e tyre e zunë trupat italiane. Në rajonin e Korçës vazhdonin të qëndronin trupat franceze, ndërsa në Shkodër një forcë e përbashkët e trupave aleate. E ardhmja e

Shqipërisë ishte e paqartë. Faktori politik shqiptar ishte i përçarë, ndërkohë që princ Vidi e kishte humbur mbështetjen brenda dhe jashtë vendit. Lufta kishte patur pasoja të mëdha. Së pari në arenën ndërkombëtare, gjashtë Fuqitë e Mëdha, krijueset dhe garantueset e Shqipërisë nuk egzistonin më si në formatin e paraluftës. Disa shtete ishin mundur, të tjera kishin ndyshuar qëndrimet e tyre në lidhje më Shqipërinë. Së dyti gjatë periudhës së luftës ishte nënshkruar Trakati i Fshehtë i Londrës i cili copëtonte Shqipërinë.

Ndërkohë gjatë luftës në Shqipëri ndodhën 3 ngjarje të rëndësishme a) shpallja e vetqeverimit në Korçë, 2) proklamata e 23 janarit 1917 nga autoritetet austro-hungareze në Shqipëri 3) proklamatën e lëshuar nga gjenerali italian Ferrero. Të treja këto ngjarje ishin shprehje e dëshirave të popullsisë lokale që kishin detyruar autoritet ushtarake të ndërmerrnin këto hapa.

Për të mbrojtur shtetin e tyre shqiptarët u përballën me kërkesat e Italisë, e cila ishte shndërruar nga mbrojtëse e shtetit shqiptar, në një shtet që rrezikonte pavarësinë e Shqipërisë dhe frenuan ambicjet e Greqisë dhe shtetit të ri SKS. Për t'ju përgjigjur nevojave të vendit në janar 1919 në Durrës u mblodh një Kongres i cili zgjodhi një qeveri të përkohshme. Kongresi ngriti një delegacion i cili do të përfaqësonte Shqipërinë në Konferencën e Parisit. Delegacioni shqiptar i përbërë nga Turhan pashë Përmeti, Mehmet Konica, Mithat Frashëri dhe Mihal Turtulli paraqiti pretendimet në Konferencën e Parisit në një varg memorandumesh të cilat i bënin me dije konferencës, se shqiptarët përkrahin parimin e vetvendosjes dhe kërkonin që Shqipërisë ti riktheheshin territoret që i ishin marrë nga vendimet e vitit 1913. (Historisë, 2016, p. 421)

Konferenca nuk i mori parasysh kërkesat shqiptare, por nisi të shqyrtonte propozimet greke. Çështja shqiptare kaloi për shqyrtim tek Komisioni për Çështjet Greke, që ishte krijuar në shkurt 1919 pranë Konferencës së Paqes, përbërë nga Franca, Anglia, ShBA dhe Italia. Delegacioni grek paraqiti përpara Këshillit Suprem të Konferencës së Paqes pretendimet territoriale për Jugun e Shqipërisë, në një rajon ku banonin sipas tij 120 mijë greke dhe 80 mijë shqiptarë. U argumentua gjithashtu se ishte e drejtë që pakica shqiptare të përfshihej në Greqi për shkak të qytetërimit të saj epror. (Swire, 2005 , p. 241)

Për çështjen shqiptare Fuqitë e Mëdha ishin të ndara. Italia ishte që kufijtë e jugut të mbeteshin ata të vitit 1913, Anglia dhe Franca ishin

për dhënien e Korçës dhe Gjirokastrës Greqisë, ndërsa ShBA e quante të mjaftueshme që Italisë ti jepej Vlora, Gjirokastra ti jepej Greqisë, kurse Korça ti lihej Shqipërisë. Për shkak të mosmarrëveshjeve çështja e Shqipërisë mbeti e hapur dhe u diskutua në kuadrin e çështjes së Adriatikut. (Duka, 2007, p. 103)

Në Itali kabineti i Vittorio Orlandos dha dorëheqjen dhe u zëvendësua nga kabineti i Francesco Nittit i cili gjykonte se çështja e Adriatikut duhet të merrte zgjidhje të shpejtë. Ai e ndryshoi politikën italiane për jugun e Shqipërisë duke përkrahur synimet e Greqisë për pretendimet italiane gjetkë. Në këtë frymë u nënshkrua marrëveshja Venizelos-Titoni. (Joseph, 2011) Marrëveshja ngjalli pakënaqësi tek fuqitë e tjera. Franca refuzoi të linte Korçën derisa të arrihej një marrëveshje e përgjithshme. Anglezët u irrituan nga prania kaq e madhe e italianëve në Adriatik, ndërkohë që ata nuk ishin pjesë e kësaj marrëveshjeje. Goditjen vendimtare kësaj marrëveshjeje i'u dha nga presidenti Wilson i cili deklaroi se nuk mund të bënte një padrejtësi kundrejt Shqipërisë. (Macmillan, 2006, p. 422) Përballë mosdakortësisë nga ana e Fuqive të Mëdha çështja shqiptare u shty.

Në këtë situatë mes shqiptarëve filluan mosmarrëveshjet. Përfaqësuesit e diasporës i'u kundërvunë, italofilëve të qeverisë së Durrësit. Qëndrimi për një shtet kujdestar ndaj Shqipërisë përçau edhe delegacionin e Durrësit. Mihal Turtulli dhe Mehmet Konica kishin kritika për mënyrën sesi delegacioni shqiptar po e trajtonte çështjen e Italisë. Delegacioni nuk ishte shprehur qartë për zbrazjen e Vlorës nga ana e Italisë dhe një shtet mbrojtës i Shqipërisë nuk mund të shkëputeste pjesë të vendit. (Puto, 2003, pp. 306-307)

Ngjarjet në Shqipëri morën një tjetër zhvillim si pasojë e lëvizjeve të brendshme politike-ushtarake. Kongresi i Lushnjës i mbajtur në janar 1920, rrëzoi qeverinë e Durrësit. Qeveria e re e dale nga ky kongres tregua mjaft aktive. Ajo nisi bisedimet me qeverinë e Romës për çështjen e Vlorës, kurse fshehurazi përkrahu kryengritjen anti-italiane që nisi në Vlorë. Kryengritësit shqiptarë luftuan më trimëri dhe shfrytëzuan si gjendjen e vështirë të trupave italiane në Shqipëri dhe situatën e brendshme në Itali ku kishin shpërthyer greva të shumta, për të detyruar qeverinë italiane, që më 20 gusht 1920 të nënshkruante protokollin paraprak, ku Italia respektonte integritetin territorial të Shqipërisë. (Duka, 2007, pp. 110-118)

Pas zgjidhjes së problemit italian, përpjekjet e qeverisë shqiptare u përqëndruan në aderimin e saj në Lidhjen e Kombeve. Mbështetja e Britanisë së Madhe e zgjidhi çështjen në favor të palës shqiptare. Britania pas propozimit të dy përfaqësuesve të zotërimeve të saj, ato të Kanadasë dhe Afrikës së Jugut bëri që Shqipëria të pranohej në Lidhjen e Kombeve. (Puto, 2003, p. 345) Ndonëse Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve qeveria e saj nuk u njoh.

Çështjet kufitare me shtetin SKS dhe Greqinë morën vëmendjen e qeverisë shqiptare. Do të ishte Konferenca e Ambasadorëve e cila me vendimin e e 9 nëntorit 1921 shpallte njohjen e qeverisë shqiptare si një qeveri e një shteti sovran dhe të pavarur. Vendimi i 9 nëntorit gjithashtu përcaktonte krijimin e një komisioni për caktimin e kufirit jugosllavo-shqiptar. Përsa i përkiste kufirit me Greqinë, atë kishte caktuar Konferenca e Ambasadorëve në Londër e vitit 1913 me anë të komisionit për kufijte e jugut. (Kotta, 2016, p. 72) Komisioni Ndërkombëtar Kufirit me gjithë divergjencat që kishte arriti të përfundonte punën. Pasi zhvilloi takimin e fundit më 10 dhjetor 1913 në Gjirokastër ai u largua në drejtim të Firences ku u hartua protokolli i Firences i cili u firmos nga gjashtë anëtarët. Vija kufitare e Firences është thuajse vija e kufirit shqiptaro-grek. (Dushku, 2012, p. 217)

4. Ballkani, aty ku lufta vazhdon. Lufta greko-turke e viteve 1919-1922

Lufta e Parë Botërore përfundoi më 11 nëntor 1918, por në Ballkan, Greqia në vitin 1919 filloi një konflikt të ri. Greqia hyri në LIB pa marrëveshje specifike për kërkesat e saj. Vetëm Traktati i Fshehtë i Londrës parashikonte që Greqia të zgjerohej territorialisht në jug të Shqipërisë. Pavarësisht kësaj qeveria greke dhe Venizelosi kishin pretedime të mëdha. Ai shfrytëzoi të gjitha historinë, fenë, gjuhën dhe sigurisht vetvendosjen. Greqia duhej të kishte pjesën jugore të Shqipërisë, së paku Trakën Perëndimore, disa ishuj dhe një pjesë të mirë të Azisë së Vogël. (Macmillan, 2006, pp. 410-411) Për të arritur këto qëllime duhej fituar përkrahja e Fuqive të Mëdha, Francës, Britanisë dhe SHBA. Në fakt edhe situata gjeopolitike ishte në favor të saj.

Kur Venizelosi e paraqiti çështjen greke tek Këshilli Suprem, ai ishte i bindur që Britania do të qëndronte përkrah Greqisë. Po jo vetëm kaq, sepse ai mendonte të mbështetej edhe tek Franca, tashmë

që trupat greke po luftonin në krah të francezëve kundër bolshevikëve. Amerikanët ishin dashamirës ndërsa meraku i tij më i madh ishte Italia. (Macmillan, 2006, p. 414). Konferenca e Parisit ishte arritja kryesore e diplomacisë së Venizelos, ku ai përdori të gjitha mjetet diplomatike për të arritur qëllimet për Greqinë. Ai ishte mjeshtër i argumenteve për të mbështetur pretendimet greke. Miqësia e tij me Lloyd George i dha një avantazh në bisedimet diplomatike. (Smith, 2006, p. 161)

Për pretendimet bullgare Venizelosi nuk hasi në vështirësi të mëdha. Fuqitë e Mëdha i'a plotësuan kërkesat, duke i'u imponuar Bullgarisë edhe për faktin se ajo ishte shtet i mundur. Me Shqipërinë ndryshonte puna, sepse Shqipëria në fillim të konfliktit kishte shpallur asnjëanësinë e saj dhe aty ndërthureshin interesat e disa shteteve fituese të luftës

Më 10 gusht 1920 midis Fuqive Aleate e Shoqe dhe PO u nënshkrua me Traktati i Sevrës. Sipas traktatit, Greqia do të merrte Trakën Lindore. Përveç kësaj ajo do të administronte Smirnën dhe rrethinat e saj për 5 vjet. Pas kësaj periudhe ishte parashikuar që të mbahej një plebishit popullor. Greqisë iu dhanë edhe dy ishujt strategjikë të Tonedos dhe Imbros, ndërkohë që ngushticat u ndërkombëtarizuan. (https://www.britannica.com/event/Treaty-of-Sevres) Greqia nga ana e saj angazhohej të siguronte mbrojtjen e jetës dhe lirive të të gjithë banorëve të saj, pa dallim të vendlindjes, kombësisë, gjuhës, racës apo fesë. Të gjithë banorët e Greqisë do të lejoheshin të ushtronin lirisht publikisht e privatisht fenë e besimin. Greqia pranonte dhe deklaronte se ata do të ishin shtetas grekë pa kërkuar ndonjë formalitet individët e kombësive bullgare, turke ose shqiptare të cilët ishin rezidentë në territoret që i ishin dhënë Greqisë prej traktateve ndërkombëtare qysh prej 1 janarit të vitit 1913. (Smith, 2006) Ky moment përbënte kulmin e triumfit të Megali Idesë dhe realizimin e ëndrrës së vjetër greke.

Kjo ishte vetëm një pjesë e ambicjeve të Venizelosit. I përkrahur nga aleatët, veçanërisht kryeministri britanik George, trupat greke zbarkuan në Smirna më 15 maj 1919. Venizelos në Athinë, e përshkroi çështjen si një zgjedhje e ndërmarrë sipas kushteve të traktatit dhe të pretendimeve greke dhe si përgjigje ndaj presionit të qarqeve ushtarake franceze, italiane dhe britanike. Prandaj, në këtë pikë kritike për historinë e kombit, ai duhej merrte vendimin që trupat greke të ishin në krah të forcave britanike në Turqi. Ai kishte shtuar se nëse edhe kjo

nuk do t'i detyronte turqit të nënshkruanin traktatin, ai do të merrte përsipër të rriste forcën e ushtrisë greke, forca të cilat së bashku me trupat britanike do ti impononinn traktatin Turqisë. (Smith, 2006, p. 164)

Ata pushtuan qytetin dhe përparuan në brendësi të vendit dhe morën kontrollin e pjesës perëndimore dhe veriperëndimore të Anadollit. Britania inukrajoi Greqinë që të përparonte drejt brendësisë së territoreve turke, me qëllim që të bindte sulltanin të heshte, por edhe të ushtronte presion mbi Ataturkun dhe pasuesit e tij. Forcat greke pushtuan Bursën dhe përparuan në brendësi të rrafshnaltës së Anadollit. Ata gjithashtu pushtuan Trakinë Lindore dhe Adrianopojën. Ushtria greke ishte nën komandën e Venizelos dhe ai shpresonte të nxirrte përfitime territoriale nëse Turqia nuk i pranonte kushtet e traktatit. Traktati i Sevres u nënshkrua në 10 gusht por asnjëherë nuk u ratifikua apo zbatua. (Smith, 2006) Sulltani pranoi kushtet e paqes duke sjellë përmbysjen e qeverisë osmane.

Në krye të lëvizjes revolucionare ishte një gjeneral i quajtur Qemal Ataturk. Ai kishte treguar aftësi të mëdha në luftë kundër rusëve dhe në fushatën e Dardaneleve. Pas luftës ai filloi të organizojë një rezistencë kundër sulltanit dhe fuqive aleate. Në fillim ai nuk gjeti mbështetje në popullsinë turke e cila vazhdonte të mbështeste sulltanin-kalif. Por situata ndryshoi kur grekët u futën në Traki dhe sidomos kur zbarkuan në Smirne. Trupat greke filluan të avancojnë në brendësi të territoreve turke. Si pasojë Ataturku gjatë vitit 1919 e zhvendosi qendrën në Ankara, por ngaqë sulltani kishte akoma mbështetje ai nuk i doli menjëherë kundër. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006) Pozicioni i Greqisë në këto momente dukej mjaft i favorshëm. Kundërshtarët e saj në Ballkan, Bullgaria dhe PO ishin mundur. Në gusht të vitit 1920 forcat greke filluan një fushatë kundër turqve të cilët u tërhoqën në thellësi të Anadollit. Trupat greke hynë në brendësi të Anadollit në një truall të panjohur dhe armiqësor. (Macmillan, 2006, p. 511)

Pikërisht në këtë moment filluan problemet për Venizelosin. Ai i ishte drejtuar mbështetjes së huaj për të fituar mbi kundërshtarët tij politikë. Politika e mbretit mund të kishte qenë gabim, por Venizellos nuk kishte pse të lidhej me fuqitë e huaja për ta detyruar atë të hynte në luftë dhe nuk duhet ta kishte marrë pushtetin duke shfrytëzuar forcat aleate. Arritjet e Venizellosit dhe politika e tij pro-Antantës nuk e zvogëloi kundërshtimin ndaj precedentit që ai kishte vendosur për sovranitetin e Greqisë nga Fuqitë e Mëdha. Arritjet territoriale të

Greqisë sipas Traktatit të Sevres vlerësoheshin si e drejtë e tyre, në bazë të parimit të kombësisë. (Toynbee, 1922, p. 109).

Rikthimi në fuqi të mbretit Konstandin I, i njohur për qëndrimet e tij progjermane bëri që Anglia dhe Franca të rishikonin mbështetjen e mëtejshme të planeve ekspansioniste territoriale greke në Azinë e Vogël. (Milo, 2013, p. 500) Kthimi i tij nuk do të thoshte braktisje e politikës së Venizelosit në Turqi. Ndonëse rojalistët e kishin kritikuar këtë fushatë edhe ata ishin përfshirë në valën e entuziazmit të realizimit të Megali Idesë, por më 24 gusht 1921 marshimi i trupave greke u ndal përgjatë bregut lindor të lumit Sakaria në Anadollin Qëndror. Për dy javë trupat greke sulmuan pozicionet e fortifikuara turke në një betejë të ashpër ku të dyja palët humbën gjysmën e trupave dhe si pasojë e rezistencës më 16 shtator trupat greke filluan të tërhiqen. Fitorja ndaj grekëve bëri që pushteti tashmë të ishte në duart e Ataturkut dhe jo në Kostandinopojë.

Në këtë situatë, Ataturku gjeti një aleat të vlefshëm Bashkimin Sovjetik. Afrimi i tij me regjimit bolshevik tregoi nevojën e Turqisë për mbështetje ndërkombëtare ushtarake dhe diplomatike. Përfundimii një serie marrëveshjesh dypalëshe, zgjidhën çështjen e mprehtë të kufijve të Kaukazit. Suksesi i tij diplomatik vazhdoi edhe më tej kur Franca evakuoi trupat e saj nga territoret turke në këmbim të favoreve ekonomike. Në tetor të vitit 1921 Italia, Franca, BS kishin bënë marrëveshje me Qemal Ataturkun dhe jo me sulltanin që vazhdonin ta mbështesnin vetëm Britania dhe Greqia. (Klapsis, p. 85) Trupat britanike ishin stacionuar në Stamboll prandaj Ataturku duhet vetëm të përzinte ushtrinë greke nga Anadolli.

Në gusht të vitit 1922 udhëheqësi turk nisi një fushatë kundër trupave greke të cilat nuk qenë në gjendje të përballonin sulmin. Në 9 shtator pasi kishin dërrmuar trupat greke, ushtria turke hyri në Smirna. Pas kësaj vëmendja u kthye në Trakën Lindore. Si shefat e tyre në Londër, Paris, Romë edhe diplomatët në Smirne i braktisën grekët. Me dështimin e aleatëve për të imponuar vendimet e tyre Stambolli dhe ngushticat u kthyen nën kontrollin turk. (Macmillan, 2006, p. 512) Më 1 nëntor 1922 asambleja turke deklaroi se sulltanati pushonte së ekzistuari. Sulltan Muhamedi VI u largua me një anije britanike. Traktati i Sevrës pushoi u hodh poshtë, një marrëveshje e re do të bëhej me turqit që tashmë përfaqësonin një kauzë fitimtare.

Bisedimet filluan në nëntor 1922 dhe vazhduan deri më 23

korrik 1923, kur u nënshkrua Traktati i Lozanës. Sipas këtij traktati turqit mbanin krejt Anadollin, Trakinë Lindore, ngushticat si dhe ishujt e Tenedos dhe Imbros. Nuk u përcaktuan dëmshpërblime dhe kapitullimi i Perandorisë Osmane u hoq. Me gjithë përpjekjet turke dhe sovjetike, Britania siguroi një zgjidhje optimale për interesat e veta. (Mantran, 2004, p. 572) Ngushticat do të çmilitarizoheshin dhe do të ishin te hapura për të gjitha anijet kur Turqia nuk ishte në luftë.

Përfundime

Luftrat ballkanike ishin fillimi i një periudhe përplasjesh e konfliktesh në Ballkan që zgjatën 10 vjet. Dëshirat për zgjerim territorial shkaktuan vdekje dhe shkatërime në Ballkan, tragjedi të cilat u përligjën me fitoret territoriale. Ambicjet e politikanëve ballkanas shpesh iu kundërvunë këshillave të diplomatëve europiane, realpolitika përcaktonte marrëdhëniet midis vendeve ballkanike.

Diplomacia e Fuqive të Mëdha shfrytëzoi ambicjet e vendeve ballkanike gjatë Luftës së Parë Botërore duke lidhur me këto shtete marrëveshje të fshehta që sollën edhe më shumë vështirësi në periudhën e pas luftës. Një nga traktatet me problematikë rezultoi të ishte Traktati i Fshehtë i Londrës. Aty ishin të përfshira tre Fuqi të Mëdha dhe 4 shtete ballkanike. Secili kërkonte të realizonte atë që i ishte premtuar. Bullgaria u rreshtua përkrah Fuqive Qëndrore, ndërsa, Rumania, Serbia, Mali i Zi dhe Greqia përkrah Antantës. Asnjëanësia e Shqipërisë nuk u respektua, territori i saj u shkel e u pushtua nga të gjithë. Ballkani gjatë kësaj lufte u shndërrua në teatër betejash e operacionesh.

Në fund të Luftës së Parë Botërore vendet ballkanike ishin më larg njëra-tjetrës se në fillim të konfliktit sepse politikanët e Ballkanit gjatë 4 luftrave u udhëhoqën nga parimet e vjetra të përfitimeve territoriale dhe në asnjë moment nuk pati përpjekje të sinqerta për bashkëpunim midis vendeve të Ballkanit.

Fundi i Luftës së Parë Botërore solli ndryshime të mëdha në hartën politike të Ballkanit. Shpërbërja e monarkisë shumëkombëshe Austro-Hungareze, solli zgjerimin e Serbisë dhe Rumanisë, kurse dalja e Rusisë nga lufta i la dorë të lirë Rumanisë për të aneksuar Besarabinë. Kësisoj Rumania dhe Serbia përfituan shumë në këtë kohë ndryshimesh të mëdha, por me çmimin se tani ato ishin shtete multinacionale.

Përfundimi i luftës si në mbarë botën u prit me gëzim në Ballkan, por vendimet e Konferencës së Parisit nuk u morën mbi bazën e 14 pikave të Presidentit Willson, por mbi bazën e interesave të Fuqive të Mëdha. Në këto vendime nuk dominoi e drejta për vetvendosje por imponimi i më të fortit gjë që nuk lejoi krijimin e një rajoni të qetë.

Humbja e Perandorisë Osmane, në Greqi krijoi iluzione se ishte koha për të përmbushur Megali Idenë. Greqia dhe Turqia vazhduan luftën deri në vitin 1922 duke i shkaktuar njëra-tjetrës humbje njerëzore, ushtarake, ekonomike pasoja të mëdha për të dy vendet.

Bibliografi

Akademia e studimeve Albanologjike. (2016) Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX.

Anghel, Ion M. (2016) The Borders of Greater Romania", Annals of the Academy of Romanian Scientists, Series on History and Archaeology, ISSN 2067-5682 Volume 8, Number 1/2016 http://aos.ro/wp-content/anale/IVol8Nr1Art.2

Ann Haynes, Rebecca. (2005) A new Greater Romania? Romanian claims to the Serbian Banat in 1941", Central Europe, Vol. 3, No. 2, November 2005,

Bakic, Dragan. Nikola Pasic and the Foreign Policy of the Kingdom of Serbs, Croats and Slovenes, 1919–1926, Institute for Balkan Studies Serbian Academy of Sciences and Arts Belgrade, DOI: 10.2298/BALC1647285B,

Bashkurti, Lisen. (2014) Nga Koncerti i Vjenës në Funeral Botëror. Tiranë: Global Challenge

Crampton, Richard J. (2011) Aleksandur Stamboliiski. Bulgaria: The Peace Conferences of 1919-23 and Their Aftermath (Makers of the Modern World). London: Haus Publishing Ltd,

Dalby, Andrew. (2011) Eleftherios Venizelos. Greece: The Peace Conferences of 1919-23 and their Aftermath (Makers of the Modern World). London: Haus Publishing Ltd

Duka, Valentina. (2007) Histori e Shqipërisë 1912-2000. Tiranë: Shblu

Dushku, Ledia. (2012) Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia 1912-1914. Tiranë: Qëndra e Studimeve Albanologjike. Instituti i Historisë

Frashëri, Kristo. (1997) Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881. Tiranë: Toena

Gay, Nicola. (2012) Lindja e Shqipërisë. Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare. Tiranë: Pegi

Glenny, Misha. (2000) Historia e Ballkanit 1804-1999. Tiranë: Toena

Hitchins, Keith. (2011) Ionel Bratianu. Romania: The Peace Conferences of 1919-23 and Their Aftermath (Makers of the Modern World). London: Haus

Publishing Ltd 70
https://www.britannica.com/place/Bulgaria/World-War-I
Jelavich, Charles e Barbara. (2006) Themelimi i shteteve kombëtare në Ballkanit 1804-1920
Joseph, Swire. (2005) Shqipëria ngritja e një mbretërie, Tiranë: Dituria
Klapsis, Antonis. (2002) "Turkey's search for a neë foreign policy, 1923-1925: The View of Greek Diplomacy": www.imxa.gr/files/bsfiles/46/BalkanStudies(5)%20Klapsis%20final%2002
Kotta, Nuçi. (2016) Shqipëria dhe çështja e kufijve shqiptaro grek. Tiranë: Bota shqiptare
Lory, Benard. (2007) Europa Ballkanike, nga 1945 në Ditët Tona. Tiranë: Dituria
Macmillan, Margaret. (2006) Paris 1919, Gjashtë muaj që ndryshuan botën. Tiranë: Plejad
Michael.Ll Smith, Venizelos' Diplomacy, 1910–23, From Balkan Alliance to Greek-Turkish Settlement
Pavlovic, Vojislav. (2017) The Treaty Of London And The Creation Of Yugoslavia, Acta Histriae, Doi 10.19233/Ah.2017.48), https://www.britannica.com/event/Treaty-of-Sevres
Puto, Arben. (2003) Historia diplomatike e çështjes shqiptare. Tiranë: albin
Rothshild, Joseph. (2004) Europa Lindore Qendore midis dy luftrave botërore. Tiranë: Dituria
Schevill, Ferdinand. (2006) Ballkani Historia dhe Qytetërimi. Tiranë: Uegen
Schurman, Jacob Gould. (2006) Luftrat Ballkanike 1912-1913. Tiranë: Uegen,
Sherman D. Spector, (1962) Romania at the Paris Peace Conference, A study of the diplomacy of Ioan Bratiuaun New York: Bookman associates. http://aos.ro/editura/analeleaosr/annals-on-history
Smith, Michael Llewellyn. (2006) Venizelos' Diplomacy, 1910–23: From Balkan Alliance to Greek-Turkish Settlement, Edinburgh University https://doi.org/10.1515/9780748627004-01
Toynbee, Arnold J. (1922) The Western Question in Greece and Turkey, A Study in the Contact of Civilisations, http://louisville.edu/a-s/history/turks/WesternQuestion
Veremis, Thanos and Gardikas-Katsiadakis, Helen. (2006) Eleftherios Venizelos. Protagonist in politics 1912-1920. Edinburgh: Edinburgh University Press

Viti XXIX i botimit, nr. 36, 2024

BULETINI SHKENCOR
SCIENCE BULLETIN

(Seria e shkencave shoqërore)